

PERËNDIA KUJDESET KUR FËMIJËT JANË TË MËRZITUR!

Teksti: Paul Reid

Ilustruar nga: Tim Shirey

JU LUTEMI VINI RE!

Vizualet për këtë seri mund të blihen në pjesën më të madhe të zyrave të BUF-it dhe në dyqanet në internet. Për një listë të zyrave të BUF-it dhe dyqaneve në internet në Evropë, ju lutemi vizitoni www.teachkids.eu/al dhe kliko mbi “Vendet”.

Teksti i publikuar nga:

CEF® of Europe
Kilchzimmer
4438 Langenbruck
Switzerland
www.cfeurope.com



BUF SH
BASHKËSIA E UNGJILLIZIMIT
TË FËMIJËVE E SHQIPËRISË*

Copyright © 2006 European Child Evangelism Fellowship

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përdorur me leje.

Mund të riprodhohet vetëm për përdorim personal, shërbese, jofitimprurës ose jo-komercial. Vizitoni www.teachkids.eu/al për më shumë detaje mbi lejen e përdorimit.

Pasqyra e lëndës

Mësimi		Faqe
Hyrje		3
Përmbledhje		6
Mësimi 1	I dëbuar qe u pranua nga Perëndia (Jefteu) Fokusi: Një fëmijë i refuzuar prej vëllezërve nga njerka	7
Mësimi 2	I huaji i mirëpritur (Ruth) Fokusi: Një fëmijë që është ndryshe nga ngjyra, rraca, etj.	13
Mësimi 3	I pastër në një botë të ndyrë (Samueli) Fokusi: Një fëmijë që qëndron i pastër pavarësisht nga jetët imorale të shokëve më të mëdhenj.	21
Mësimi 4	Të mësosh të falësh të tjerët (Pjetri) Fokusi: Një fëmijë i lënduar nga të tjerët mëson të falë	27
Mësimi 5	I përçmuar prej të tjerëve, i falur prej Perëndisë (Mateu) Fokusi: Një fëmijë pranon faljen e Perëndisë	33
Modele	Perëndia i pranon dhe i përdor ata që besojnë në Të (mësimi 1)	40
	Perëndia të do (mësimi 1)	41
	Besoji Perëndisë (mësimi 2)	42
	Faqembajtës (mësimi 3)	43
	Të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë (mësimi 3)	44
	Falja (mësimi 4)	45
	Çfarë bën Perëndia me mëkatet tona? (mësimi 5)	46
Përmbledhje e hapave për këshillimin e fëmijës që dëshiron të vijë tek Krishti		48

Hyrje

Këto mësim biblike janë shkruar për t'u dhënë mësim fëmijëve mbi dashurinë e Perëndisë dhe për t'u kujdesur për ta, veçanërisht ndërsa përballen me situata të vështira

Zbatimet

Zbatimet janë bërë për:

- ◆ fëmijët që përballen me ndarje në familje.
- ◆ fëmijët që refuzohen për shkak të disa dallimeve nga fëmijët e tjerë.
- ◆ fëmijët që përballen me shumë presion nga të tjerët për t'i shtyrë në gabime – për shembull, vjedhje, marrja e pijeve alkoolike, shikimi i pamjeve ose videove të “pista”.
- ◆ fëmijët që janë lënduar nga të tjerët dhe që kanë nevojë të mësojnë të falin.

Mësimet biblike kanë aplikime për fëmijët e shpëtuar dhe të pa shpëtuar

Synim

Një synim është dhënë për çdo mësim në përpjekje për t'iu ndihmuar të mendoni se çfarë dëshironi që të ndodhë, me hirin e Perëndisë, në jetën e fëmijëve. Synimi shpreh dëshirën dhe qëllimin e mësuesit. Nuk garanton se kjo do të ndodhë automatikisht. Për shembull, nëse synimi për një mësim është shprehur kështu “Fëmijët do të besojnë në Krishtin për shpëtim”, ajo është lutja, dëshira dhe synimi i mësuesit, - por vetëm Fryma e Shenjtë mund ta bëjë këtë realitet në jetën e fëmijës

Mësimdhënia e të vërtetave biblike

Ne nuk marrim përgjegjësitë tona si mësues nëse u tregojmë fëmijëve vetëm histori biblike. Është thelbësore që fëmijët të mësojnë ato të vërtetat për të cilat këto histori u shkruan dhe që ne më pas t'i çojmë ata një hap më përpara duke i treguar se çfarë kuptimi ka e vërteta për ta në jetët e tyre të përditëshme. Sigurisht që nuk mund të mbulojmë të gjithë mësimin që çdo histori e veçantë jep, kështu që në çdonjërin prej këtyre mësimëve është zgjedhur një e vërtetë qendrore. Mësimi i së vërtetës qendrore është ndërthurur përgjatë tregimit, por për t'ju ndihmuar në përgatitjen tuaj, sesionet e mësimit janë shënuar me “VQ”. Këto janë shënuar gjithashtu edhe në planin mësimor.

Do të shihni që të vërtetat qendrore janë shënuar me një “P” ose një “Sh” për të treguar se kujt fëmije i zbatohet e vërteta – të pashpëtuarit apo të shpëtuarit. Kjo është bërë gjithashtu e qartë edhe në tekst duke përdorur fraza si, “Nëse nuk i ke besuar Zotit Jezus për faljen e mëkateve...” ose “i krishterë, ti...”.

Zbatimi i së vërtetës është shënuar me një vijë anash tekstit. Mund ta gjeni me vend që t'i përshtatni zbatimet ashtu si u përshtaten më mirë fëmijëve që juve u jepni mësim. Për shembull zbatimi mund të përdorë emrin e një djali, por ju keni vetëm vajza në grup. Mund të ndodhë që zbatimi i dhënë është më i përshtatshëm për fëmijë më të rritur, ndërsa në grupin tuaj janë shumë të vegjël. Bëni ndryshimet që i ndieni të nevojshme. E rëndësishme është që Fjala e Perëndisë të zbatohet në jetët e tyre.

Vendoseni veten tuaj në dispozicion për këshillim

Kur prezantoni mesazhin e ungjillit, do të ketë fëmijë që do të reagojnë ndaj tij në mënyrë të pavarur. Ata mund ose mund të mos ju thonë që i kanë besuar Zotit Jezus Krisht si Shpëtimtar. Megjithatë, do të ketë të tjerë që do të duan pak ndihmë. Ata mund të kenë pyetje për të bërë; ata mund të kenë nevojë për ndihmë ose inkurajim për të ditur se çfarë të thonë.

Ndërsa u jepni mësim fëmijëve të shpëtuar, mund të ketë raste kur ata do të duan këshillë për një situatë të vështirë; mund të kenë nevojë për qartësim për mënyrën se si zbatohet një mësim i veçantë në jetë e tyre të përditëshme; mund ta gjejnë veten e tyre në një situatë në të cilën nuk e dinë se çfarë thotë Bibla për atë që duhet të bëjnë; ata mund të tregojnë për një vështirësi në mënyrë që ju të luteni për ta, veçanërisht nëse jeni e vetmja mbështetje e krishterë që ata kanë.

Për këto arsye është e rëndësishme që fëmijët të dinë se ju jeni në dispozicion për të folur. Është gjithashtu e rëndësishme që ata të dinë se kur dhe ku të shkojnë kur duan të flasin me ju. Së fundi, është thelbësore që fëmijët e pashpëtuar të mos e ngatërrojnë të ardhurit tek Zoti Jezus me të ardhurit tek ju.

Në të gjitha rastet nuk duhet ta vini veten tuaj në dispozicion në të njëjtën kohë ndërsa jepni ftesën e ungjillit, në mënyrë që fëmijët të mos kenë kurrë përshtypjen se ata nuk mund të vijnë tek Krishti pa ardhur tek ju, ose se thjeshtë janë të shpëtuar duke pritur që të flasin me ju.

Një shembull për t'u përdorur me fëmijën e pashpëtuar

“A dëshiron vërtetë të jetosh për Zotin Jezus, por nuk e di se si të vish tek Ai? Me kënaqësi do ta shpjegoj nga Bibla; eja dhe më tako. Do të jem tek ajo pema kur të mbarojë takimi. Mbaj mend se unë nuk mund të ta heq mëkatën – vetëm Zoti Jezus mund ta bëjë këtë – por me kënaqësi do të të ndihmoj të kuptosh më mirë se si mund të vish tek Ai. Eja dhe ulemi tek ajo pema.”

Një shembull për t'u përdorur me fëmijën e shpëtuar

“Nëse e ke besuar Zotin Jezus si Shpëtimtar dhe nuk më ke treguar asnjëherë për këtë, të lutem më trego. Do të jem tek piano pasi të mbarojë takimi. Do të doja ta dija nëse edhe ti e ke besuar Zotin Jezus si Zotin dhe shpëtimtarin tënd, që të mund të lutem për ty dhe ndoshta të të ndihmoj.”

Metoda mësimdhënieje

Shpesh fëmijët që jetojnë në këto rrethana të vështira janë rebelë dhe të vështirë për t'u kontrolluar në klasë. Për këtë arsye, janë përdorur një shumëllojshmëri metodash mësimi për të përfshirë fëmijët, për të tërhequr vëmendjen e tyre dhe për të përforcuar procesin e mësimi. Metodat përfshijnë tregime, pyetje, intervista, studime në grup, mësim me objekte, skeçe etj. Mësuesit duhet t'i përgatisin mësimet mirë që më parë, sepse ndonjëherë do të kenë nevojë për bashkëpunimin e ndihmësve të tjerë, për shembull në dramatizimin e një skene biblike ose në skeçe

Vargjet përmendësh

Nuk është dhënë për çdo mësim një varg nga shkrimi për t'ua mësuar fëmijëve. Në vend të kësaj kemi përfshirë tre vargje. Këshillohet që të mësohen mirë dy ose tre vargje, të cilat fëmijët do t'i mbajnë mend më pas. Nëse përpiqeni t'u mësoni pesë vargje (një për çdo mësim) fëmijët mund të mos mësojnë mirë asnjërin prej tyre.

Praktikim për përdorimin e vizualeve

Është me mend që të praktikoni përdorimin e vizualeve para se t'u jepni mësim fëmijëve. Mësohuni me flashkard (figurat) ose slajdet e PowerPoint që ta dini se kur do t'i përdorni në mësim.

Ndihmat vizuale shtesë

Në një letër printoni fjalët e së vërtetës qendrore për çdo mësim. Nëse po përdorni një flanelbord, ngjiteni letrën me flanel nga mbrapa. (Përdorni shkronjat e vogla, që edhe të vegjëlit mund t'i lexojnë me lehtësi fjalët). Vedoseni këtë letër në tabelë në fillim të mësimt ose kur jepni mësim për herë të parë të vërtetën qendrore në mësim.

Ndihma shtesë

Përgjatë hapësirave në të djathtë dhe në të majtë, janë vendosur ndihma shtesë, që japin informacion në sfond dhe ide opsionale se si ta bëni mësimin më interesant.

Këto ide janë dizenuar që të përfshijnë stile të ndryshme të mësuarit. Që të mësojnë me efektshmëri, disa

fëmijë kanë nevojë të shohin ose të shkruajnë, të tjerët kanë nevojë të dëgjojnë ose flasin, të tjerët kanë nevojë të prekin ose të mbajnë dhe të tjerë kanë nevojë për pjesëmarrje aktive.

Sipas kohës që keni mund t'i përdorni këto ide në klubin tuaj.

Përsëritja e pyetjeve

Për çdo mësim janë dhënë disa pyetje për përsëritje. Këto mund të përdoren pas mësimit ose javën e ardhshme, para se të jepet mësimi i ri.

Koha e përsëritjes, nëse bëhet me rregull, mund të jetë një mundësi ideale për të përforcuar atë që keni dhënë mësim, ndërsa është edhe argëtuese për fëmijët. Mund ta përdorni këtë kohë për...

- 1 të parë se sa kanë kuptuar fëmijët dhe sa kanë mbajtur mend.
- 2 t'ju ndihmuar se çfarë të theksoni më shumë ndërsa jepni mësim në mënyrë që fëmijët të mbajnë mend më mirë.
- 3 të pasur një kohë argëtimi në klasë. Fëmijët i pëlqejnë garat dhe mezi i presin këto pjesë të programit. Por është më shumë se sa vetëm një lojë: është një kohë mësimi.

Në tekst janë përfshirë vetëm pyetjet mbi mësimin. Do të ishte e dobishme që të përfshiheshin edhe pyetje mbi këngët, vargjet dhe çdo gjë tjetër për të cilën do të jepni mësim.

Aktivitete

Janë siguruar ide për aktivitete për disa mësimet. Nuk është e domosdoshme që të keni aktivitet çdo javë.

Përmbledhje

Mësimi	E Vërteta Qendrore	Zbatimi	Vargu përmendësh
I dëbuari që u pranua nga Perëndia (Jefteu) Gjyqtarët 11:1-12:7 Hebrenjve 11:32	Perëndia i pranon dhe i përdor ata që besojnë në Të	I Pashpëtuar: Besoji Zotit që të të shpëtoj prej ndëshkimit për mëkatet e tua I Shpëtuar: Besoji Perëndisë në të gjitha vështirësitë e tua dhe lëre Atë të të përdorë për të ndihmuar të tjerët që janë në vështirësi	“...kthehuni tek Zoti, Perëndia juaj, sepse Ai është i mëshirshëm dhe plot dhemshuri...” Joeli 2:13
I huaji i mirëpritur (Ruth) Ruth (i gjithë libri)	Perëndia i do dhe i vlerëson të gjithë njerëzit	I Pashpëtuar: Besoji Perëndisë për falje dhe pastrim I Shpëtuar: Besoji Perëndisë kur të tjerët të refuzojnë	Përsëritje e Joeli 2:13
I pastër në një botë të dyrë (Samueli) 1 Samuelit 2:12-26 1 Samuelit 3:1-21	Perëndia mund t'i pastrojë dhe t'i mbajë të pastër ata që besojnë në Të	I Pashpëtuar: Besoji Perëndisë që të të pastrojë prej mëkatit I Shpëtuar: Besoji Perëndisë që të të mbajë të pastër	“...më laj dhe do të jem më i bardhë se bora” Psalmi 51:7
Të mësosh të falësh të tjerët (Pjetri) Mateu 18:21-35	Perëndia i ofron falje të gjithëve	I Pashpëtuar: Prano faljen e Perëndisë si hapi i parë për të falur të tjerët I Shpëtuar: Falini ata që ju kanë lënduar	“Por jini të mirë... duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin” Efesianëve 4:32
I pëçmuar prej të tjerëve, i falur prej Perëndisë (Mateu) Lluka 5:27-32	Perëndia dëshiron dhe është i aftë të falë mëkanit dhe të ndryshojë jetët	I Pashpëtuar: Thiri Perëndisë që të të falë I Shpëtuar: Falendero Perëndinë që të ka falur – vazhdo t'i shërbesh Atij	Përsëritje Efesianëve 4:32

Mësimi 1

I dëbuari që u pranua nga Perëndia (Jefteu)

Shkrimi për mësuesit

Gjygtarët 11:1-12:7

Hebrenjve 11:32

E vërteta qendrore

Perëndia i pranon dhe i përdor ata që besojnë në Të

Zbatimi

I Pashpëtuar: Besoji Zotit që të të shpëtoj prej ndëshkimit për mëkatet e tua

I Shpëtuar: Besoji Perëndisë në të gjitha vështirësitë e tua dhe lëre Atë të të përdorë për të ndihmuar të tjerët që janë në vështirësi

Synimi

Mësimi është shkruar duke menduar veçanërisht për fëmijët që ndihen të refuzuar nga familjet e tyre. Qëllimi është që ata të drejtohen për tek besimi në Zotin i Cili i do ata. Ai dëshiron t'i pranojë ata si fëmijët e Tij dhe t'i ndihmojë ata në të gjitha problemet e tyre

Ku përdoret

Është veçanërisht i përshtatshëm në arritjen e fëmijëve që vijnë nga shtëpi jo të krishtera dhe veçanërisht shtëpitë që nuk funksionojnë; mundësisht jetimoret ose qendrat e riedukimit për të mitur

Vargu përmendësh

"...kthehuni tek Zoti, Perëndia juaj, sepse ai është i mëshirshëm dhe plot dhemshuri..." Joeli 2:13

Ndihmat vizuale

◆ Figura: 1-1, 1-2, 1-3, 1-4, 1-5 dhe 1-6

Dhe

◆ Vizualizoni të vërtetën qendrore në një skicë në duart mikëpritëse (shikoni faqen 40)

◆ Harta e Palestinës në kohën e Jozueut/Gjygtarëve

Metoda mësimdhënieje

◆ Në një pikë në mësim, fëmijët mund të marrin pjesë në diskutime në grup. Keni nevojë të bëni kopje të katër pyetjeve. Jepini nga një kopje çdo ndihmësi i cili do të drejtojë një diskutim të shkurtër (3-4 minuta).

- ◆ Sigurohuni që të lexoni fjali të shkurtra të vargjeve kyçe nga pasazhet që do të jepni mësim. Për shembull: Gjygtarët 11:11a, 11:29a; 11:32b. Do të jetë edhe më mirë nëse do të keni një dihmës ose një fëmijë më të rritur (të përgatitur që më parë) që të lexojë këto fjali të shkurtra

Skica e mësimit

Hyrje

"Shtëpia nuk ishte një vend i lumtur" VQ

Zhvillimi i ngjarjeve

- 1 Jefteu është dëbuar nga familja dhe vendi i tij VQP
- 2 Ai mbledh një njerëz të jashtëligjshëm rreth vetes
- 3 Amonitët i shpallin luftë Izraelit
- 4 Udhëheqësit Izraelitë ftojnë Jefteun për t'u bërë gjenerali i ushtrisë së tyre VQSh
- 5 Jefteu përpiket pa sukses të negociojë paqen me Amonitët
- 6 Fryma e Shenjtë i jep fuqi Jefteut për të mundur Amonitët VQSh
- 7 Ai është gjykatësi i Izraelit për gjashtë vjet
- 8 Ai përmendet në listën e njerëzve të besimit tek Hebrenjtë 11 VQSh

Mësimi

Figura 1-1

Shtëpia nuk ishte një vend i lumtur për Jefteun. Vëllezërit e tij më të vegjël nuk donin aspak që ai të jetonte në shtëpi me ta. Faktikisht, ata nuk ishin vëllezërit e tij. Jefteu dhe djemtë e tjerë kishin të njëjtin baba, që quhej Gilead, por nëna e Jefteut ishte një grua tjetër. Këtu kishin filluar telashet. Babai i Jefteut dhe gruaja tjetër me të cilën ai nuk ishte i martuar, kishin qenë bashkë dhe kishin një bebe. Kështu kishte lindur Jefteu. Pastaj Gileadi ishte martuar dhe kishte disa bij. Këta bij e urrenin Jefteun, gjysmë-vëllain e tyre.

“Pse po jeton ky njeri në shtëpinë tonë?” thonin ata me vete. “Në të vërtetë ai nuk është pjesë e familjes. Nëna jonë nuk është nëna e tij. Problemi është se ai është më i madhi dhe ndoshta kur Gileadi babai ynë të plaket dhe të vdesë, Jefteu do të marrë pjesën më të madhe të parave të familjes. Nuk mund ta lejojmë këtë të ndodhë! Le ta nxjerrim jashtë atë!”

Sa herë që gjysmë vëllezërit e tij e shihnin, Jefteu mund të shikonte xixëllimin e inatit në sytë e tyre. Mund të ketë menduar, “Pse janë ata kaq të inatosur me mua? Pse më trajtojnë kaq keq? A është faji im që babai im shkoi me atë grua, që ajo mbeti shtatzënë dhe kështu lindi unë. Ishte sjellja e keqe e babait tim – jo e imja! Çfarë po planifikojnë ata? Çfarë do të më bëjnë? Do të përpiqen të më lëndojnë apo të më heqin qafe? Kam frikë se së shpejti do të ndodhë diçka e tmerrshme.”

Ndoshta ti ndihesh pak si Jefteu. Ndoshta disa nga ju kanë vëllezër ose motra (gjysmë-vëllezër ose gjysmë-motra) të cilën nuk mund t’ju pranojnë. Ndiresh se nuk përshtatesh me familjen dhe ndoshta e ndien se nuk je aspak i dëshiruar. Ose ndoshta shokët e tu në shkollë ose në rrugë të bëjnë të ndihesh i padëshiruar dhe i pavlerësuar. Kjo është shumë e vështirë për ty dhe ndonjëherë të mërzit, por është Dikush i Cili të do tërësisht – Ai është Perëndia. Ai na tregon ne në Fjalën e Tij, Biblën, se Ai të do ty dhe mua shumë, shumë më tepër sesa mund të na dojë një njeri (Gjoni 3:16). Dhe Perëndia e donte gjithashtu Jefteun në shtëpinë e tij pa lumturi

VQ

Figura 1-2

Një ditë ndodhi një gjë e tmerrshme. Çfarë mendoni, çfarë i thanë duke i bërë Jefteut, gjysmë vëllezërit e tij? Le të lexojmë nga Bibla

“Ti nuk do të kesh trashëgimi në shtëpinë e atit tonë, sepse je biri i një gruaje tjetër” (nga Gjygtarët 11:2b).

Ata po i thonin atij se ai nuk i pëkiste asaj familjeje dhe se ata nuk donin që ai të rrinte aty. I gjori Jefte! Duhet të ketë menduar, “A do të më nxjerrin vërtetë nga shtëpia?” Kur pa fytyrat e tyre të inatosura, e kuptoi se do të kishte telashe. A besoni që vëllezërit do ta nxirrnin me të vërtetë jashtë atë? Le të shohim historinë në Bibël për përgjigjen.

“Atëherë Jefteu iku larg vëllezërve të tij” (Gjygtarët 11:3a).

Ai nuk mund të bënte asgjë ndërsa të gjithë gjysmë-vëllezërit e tij ishin kundër tij, kështu që iu desh t’ia mbathte para se ata ta nxirrnin jashtë.

Lexoni (ose kini një fëmijë më të rritur që të lexojë) vargun prej Biblës tuaj.

Ai u largua nga familja e tij dhe nga shtëpia e tij dhe madje edhe nga vendi i tij, që të ishte sa më larg asaj situatë të tmerrshme. I gjori Jefte!

A ndihesh ndonjëherë edhe ti si Jefteu, se je i padëshiruar ose nuk të duan? Por, Perëndia të do ty kaq shumë. Ai të do ty, por jo sepse je i mirë – të gjithë ne kemi bërë gabime dhe nuk e kemi kënaqur Atë.

Edhe ti ke bërë gabime të cilat Perëndia na ka thënë qartë të mos i bëjmë. A ke pasur në zemrën tënde mendime të hidhura, me zemërim, e urrejtje ashtu siç kishin vëllezërit e Jefteut? Po fjalët e tua? A ke përdorur të folur të keqe ose fjalë të ndyra? A ke gënjyer? Nëse po, nuk i je bindur Perëndisë. Ai urdhëron në Bibël, “secili t’i thotë të vërtetën” (Efesianëve 4:25). A i ke bërë titull të tjerëve me inat? Po veprimet e tua? A i ke lënduar të tejrët, ose ke mashtruar ose ke marrë gjëra që nuk janë të tua? Nëse po, nuk i je bindur Perëndisë i Cili urdhëron, “Nuk do të vjedhësh” (Eksodi 20:15). Ti i bën të gjitha këto gabime sepse brenda teje ke një natyrë mëkatore, por Perëndia të do ty shumë, pavarësisht nga mënyra e gabuar si jeton. Ti meriton të ndëshkohesh, por Perëndia ndëshkoi Birin e Tij Zotin Jezus Krisht në vendin tënd, në mënyrë që të të falte.

Jezusi vuajti me një vdekje mizore në kryq. Ai kurrë nuk bëri gabim. Ai ishte i përsosur. Por Ai vdiq për gabimet që kemi bërë ne, duke mos iu bindur ligjeve të Perëndisë. Jezusi vdiq por ai nuk mbeti i vdekur dhe tani është i gjallë përgjithmonë. Ai dëshiron që ti të vish tek Ai. Nëse vjen, sigurisht që Ai do të të pranojë si fëmijën e Tij. Ai do të bëhet Ati yt i dashur Qiellor. Eja tek Ai sot. Kërkoji të t’i falë të gjitha mëkatet. Kërkoji të të pranojë si fëmijën e Tij. Ai të premton se do ta bëjë këtë.

Le të përsërisim fjalët e vargut përmendësh përsëri. “...kthehuni tek Zoti, Perëndia juaj, sepse ai është i mëshirshëm dhe plot dhemshuri...” (Joeli 2:13). Perëndia është i mëshirshëm dhe i dashur. Me fjalë të tjera, Ai është i dashur dhe i mirë. Ai dëshiron të të falë dhe të të pranojë, edhe pse ti nuk e meriton. Perëndia do të të pranojë nëse kthehesh tek Ai.

Nëse nuk je shumë i sigurt se si të kthehesh tek Perëndia, eja tek unë pas mbarimit të klubit të fëmijëve. Do të bisedoja me kënaqësi me ty personalisht dhe të shpjegoja më shumë se si të mund të marrësh këtë hap shumë të rëndësishëm. Perëndia dëshiron të të falë dhe të të ndihmojë. A mendon se Perëndia do ta ndihmojë gjithashtu edhe Jefteun? ... Po, Ai e ndihmoi.

Pasi Jefteu u largua nga shtëpia e tij dhe vendi i tij, ai shkoi të jetonte në një vend tjetër. Nuk i kemi të gjitha detajet se çfarë bëri ai atje, por Bibla na tregon pak.

Lexoni Gjygtarët 11:3b nga Bibla Juaj

“Rreth Jefteut u mblodhën njerëz pa asnjë vlerë, që kryenin sulme bashkë me të.”

Lexoni vargun prej Biblës tuaj.

VQP

Vëreni veten tuaj në dispozicion për këshillim personal.

Tobi (Gjyqtarëve 11:3) ishte emri i principatës së vendosur në Lindje të Jordanit, në veri të Gileadit. Mund t'i thoni njerit prej fëmijëve më të rritur, të cilin e keni përgatitur që më parë, të tregojë në hartë Palestinën në kohën e Jozueut/Gjyqtarëve

Tregoni Amonin në hartë

Metoda e mësimdhënies: Diskutime në grupe.

Lexoni (ose kini një fëmijë më të rritur që të lexojë) vargun prej Biblës tuaj.

Ndoshta ata jetoni nduke sulmuar qytetet armike dhe duke marrë ushqime dhe gjëra të çmuara. Njëri prej armiqve të popullit të veçantë të Perëndisë, judenjve, ishte kombi i amonitëve. Njerëzit në Izrael filluan të dëgjonin për këtë grup kurajoz të njerëzve të jashtëligjshëm të cilët po fitonin betejat kundër armiqve të tyre.

Më pas, një ditë amonitët vendosën t'i shpallnin luftë popullit të Izraelit. Ata ishin një armik i fuqishëm. Udhëheqësit e Izraelit menduan, "Kemi nevojë për dikë që të jetë gjenerali ynë, nëse kjo luftë do të fillojë. Kush do të ishte një gjeneral i aftë?" Çfarë mendoni kë zgjodhën ata? Po, Jefteun

Figura 1-3

Njerëzit i dërguan lajmëtarë Jefteut që i thanë, "Kthehu në Izrael. Duam që ti të jesh gjenerali ynë në këtë luftë, pasi të fitosh luftën, mund të bëhesh gjykatësi dhe drejtuesi i kombit" (si një president i sotshëm). A do të kthehej Jefteu për të ndihmuar njerëzit që e kishin përzënë nga shtëpia e tij dhe nga vendi i tij? Para se të gjejmë përgjigjen janë disa pyetje për të cilat dua që të mendoni.

Nëse keni ndihmës të mirë, mund t'i ndani fëmijët në dy ose tre grupe. Ndhmësit tuaj mund të drejtojnë një grup në një diskutim të shkurtër, jo më shumë se 3-4 minuta. Sigurohuni që çdo grup të ketë disa fëmijë më të rritur.

- 1 Pas mënyrës se si e kishin trajtuar ata, çfarë mund të ketë ndierë Jefteu për njerëzit që tani po i kërkonin ndihmë?
- 2 Nëse Perëndia nuk do ta kishte ndihmuar si do të kishte reaguar Ai?
- 3 Me ndihmën e Perëndisë si duhet të kishte reaguar Ai?
- 4 Nëse je lënduar nga reagimet e njerëzve të tjerë ndaj teje, në çfarë mënyre do të mund të ndihmonte ty Perëndia të reagoje, nëse i beson Atij?

Pasi grupet të mbledhen përsëri bashkë, shkurtimisht përgjigjuni pyetjeve me ndihmën e fëmijëve.

VQSh

Pra, le të shohim se çfarë ndodhi

Fjala e Perëndisë thotë, "Pastaj Jefteu shkoi tek pleqtë (udhëheqësit) e Galaadit dhe populli e zgjodhi komandant dhe udhëheqës të tij" (Gjyqtarëve 11:11a).

Figura 1-4

Çfarë ndryshoi për Jefteun? Nga të qenit një i përjashtuar dhe një i jashtëligjshëm, larg vendit të tij, ai papritur bëhet gjenerali i ushtrisë. Perëndia e bëri këtë mrekulli.

Jefteu u përpoq të bisedonte me amonitët që të mos kishte luftë, por ata ishin të vendosur të luftonin dhe kështu u bë një betejë e madhe. Ne lexojmë diçka shumë të rëndësishme në Fjalën e Perëndisë.

Lexoni Gjyqtarët 11:29

"Atëherë Fryma e Zotit erdhi mbi Jefteun." Kjo do të thotë se Perëndia Frymë e Shenjtë i dha Jefteut një ndihmë dhe forcë të veçantë për

punën që e priste. Perëndia e ndihmoi Jefteun ndërsa ai doli në luftë kundër amonitëve. Le të lexojmë se çfarë ndodhi. “Zoti ia dha në dorë” (Gjygtarët 11:32). Po, Jefteu e mundi armikun. Kishte përsëri paqe në vend. Jefteu u bë gjygtari (si një president) dhe sundoi në vend për gjashtë vjet.

Figura 1-5

A nuk është e mrekullueshme se si Perëndia pranon dhe do çdo person edhe pse disa njerëz të tjerë mendojnë se këta nuk kanë vlerë?

Nëse tashmë e ke pranuar Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd, mbaj mend se Ai të do shumë. Ti je i çmuar për të. Ai i di ndienjat e lëndimit në zemrën tënde. Ai të kupton dhe kujdeset për ty. Kur ndihesh i refuzuar si Jefteu, apo i vetmuar ose i padëshiruar, besoji Perëndisë në të gjitha telashet e tua. Foli Zotit në lutje. Qetësisht falenderoje që Ai të do.

Ai të deshi ty kaq shumë sa vdiq në kryq që ti të ishe i falur dhe të bëheshe anëtar i familjes së Tij. Falenderoje Atë që është me ty në çdo telash. Ai nuk të përçmon edhe kur të tjerët e bëjnë këtë. Nëse je fëmijë i Tij, Ai gjithashtu dëshiron të të përdorë, ashtu si përdori Jefteun

Figura 1-6

Ashtu siç përdori Jefteun, Perëndia mund të të përdorë gjithashtu edhe ty nëse je në familjen e Tij. Kur Perëndia të ka pranuar si fëmijën e Tij, nuk je më i dëbuar. Nuk duhet të ndihesh i refuzuar dhe i pavlerë dhe patjetër që nuk duhet të ikësh nga shtëpia siç bëri Jefteu. Perëndia ka diçka për ty për të bërë, pikërisht aty ku je.

Ai mund të të përdorë ty pikërisht atje në familjen tënde që të bëhesh një paqe-bërës. Ai mund të të ndihmojë të jesh i mirë dhe i butë me të tjerët. Ai mund të të përdorë që të sjellësh djem dhe vajza të tjera në Klubin Lajmi i Mirë që të dëgjojnë lajmin e mrekullueshëm të dashurisë së Perëndisë.

Nëse ke marrë ngushëllimin e dashurisë së Perëndisë për ty, Perëndia mund të të përdorë për t’ia shpjeguar vargun biblik që kemi mësuar sot, një djali apo vajze tjetër që ka nevojë të dëgjojë dhe të kuptojë këto fjalë të ëmbla. Mund të jesh një ndihmë për të tjerët ashtu siç ishte Jefteu.

Në Dhjatën e Re në librin e Hebrenjve ka një listë burrash dhe grash të famshëm të cilët besuan në Perëndinë dhe me fuqinë e Perëndisë fituan beteja të mëdha. A e di emri i kujt tjetër është aty? Emri i Jefteut!

Ashtu si Perëndia e ndihmoi Jefteun në betejën e tij, Ai mund të të ndihmojë gjithashtu edhe ty. Nëse nuk e ke bërë akoma, duhet të vish tek Zoti Jezus dhe t’i kërkoksh falje për mëkatet e tua. Kthehu prej mëkateve të tua sot dhe

kthehu tek Zoti sepse “Ai është i mëshirshëm dhe plot dhemshuri” (Joeli 2:13). Ai të do dhe dëshiron të të falë dhe të marrë në familjen e Tij.

Pyetjet e përsëritjes

Lexoni (ose kini një fëmijë më të rritur që të lexojë) vargun prej Biblës tuaj.

VQSh

Shfaqni kartën me të vërtetën qendrore.

VQP

- 1 Pse u dëbua Jefteu nga shtëpia e tij? (Nëna e Jefteut nuk ishte nëna e fëmijëve të tjerë në familje – gjysmë-vëllezërit e tij nuk e pranonin)
- 2 Ku shkoi ai dhe çfarë bëri? (Ai shkoi në një vend tjetër dhe mbledhi një grup aventurierësh rreth vetes.)
- 3 Pse e thërritën Jefteun njerëzit e Izraelit që të kthehej? (Sepse një armik, amonitët, u kishin shpallur luftë)
- 4 Si reagoi Jefteu, me ndihmën e Perëndisë? (Ai u përgatit të ndihmonte popullin e tij.)
- 5 Si u përpoq Jefteu të shmangte luftën? (Ai u përpoq të bisedonte me amonitët dhe të bënte paqe.)
- 6 Prej kujt mori Jefteu fuqi të veçantë, për betejën? (Prej Frymës së Shenjtë.)
- 7 Perëndia e donte Jefteun dhe Ai të do ty gjithashtu. Cila është mënyra e mrekullueshme me të cilën Perëndia tregoi dashurinë e Tij për ty dhe mua? (Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm në tokë që të vdiste për ne në kryq.)
- 8 Pse është kaq befasuese për ne fakti që Perëndia na do? (Sepse ne kemi bërë kaq shumë gabime ndaj Tij.)
- 9 Perëndia përdori Jefteun. Nëse ke besuar në Zotin Jezus dhe je pranuar në familjen e Perëndisë, në çfarë mënyre mund të të përdorë Perëndia ty? Më thuaj dy mënyra. (Perëndia mund të të përdorë ty që të jesh një paqe-bërës në familjen tënde; që t'i shpjegosh një varg biblik një fëmije tjetër.)
- 10 A mund ta përsërisësh vargun biblik për sot? "...kthehuni tek Zoti, Perëndia juaj, sepse ai është i mëshirshëm dhe plot dhemshuri..." Joeli 2:13.)

Aktivitet

Perëndia të do

Bëni fotokopje (nëse është e mundur në letër cilësore) të modelit në faqen 41 dhe mbajini gati për fëmijët të cilët duan të marrin një, pas mbarimit të klubit.

Shpjegoni atë që duhet bërë. Palose nga mbrapa përgjatë vijave të ndërprera dhe vendose këtë fytyrë në dhomën tënde. Do të të ndihmojë të mbash mend që Perëndia të do

Mësimi 2

I huaji i mirëpritur (Ruthi)

Shkrimi për mësuesit

Ruth (i gjithë libri)

E vërteta qendrore

Perëndia i do dhe i vlerëson të gjithë njerëzit

Zbatimi

I Pashpëtuar: Besoji Perëndisë për falje dhe pastrim

I Shpëtuar: Besoji Perëndisë kur të tjerët të refuzojnë

Synimi

Fëmijët që mund të ndihen të përjashtuar prej moshatarëve të tyre për shkak të racës, fesë ose për arsye të tjera, do të kuptojnë qartë Ungjillin.

Ku përdoret

Në çdo takim ungjillizimi për fëmijë, veçanërisht ku ka minoritete etnike ose grupe kulturash.

Vargu përmendësh

Përsëritje Joeli 2:13

Ndihmat vizuale

- ◆ Figurat: 2-1, 2-2, 2-3, 2-4, 2-5 dhe 2-6
- Dhe
- ◆ Vizualizoni të vërtetën qendroren në një kartë.
- ◆ Përveç figurave që keni, sipas dëshirës mund të printoni disa emra që mund t'i vendosni në tabelë në momentet e duhura - Ruthi, Naomi, Betlehem, Orpah, Boaz, Obed, Isai, David
- ◆ Fëmijët më të rritur do ta pëlqenin një hartë të Palestinës dhe të zonës përreth, në kohën e Dhjatës së Vjetër

Metoda mësimdhënieje

- ◆ Është përdorur kryesisht metoda e tregimit
- ◆ Është përfshirë një intervistë me Ruthin në një pikë si një metodë alternative
- ◆ Të mësuarit përforcohet me një kuic përsëritës dhe një aktivitet për fëmijët e krishterë- ky aktivitet mund të bëhet në shtëpi ose mund të jetë pjesë e një ore mësimi

Skica e mësimit

Hyrje

Ruthi dhe Naomi udhëtojnë për në Izrael VQ

Zhvillimi i ngjarjeve

- 1 Largimi nga Izraeli dhjetë vite më parë
- 2 Elimeleku dhe dy bijtë e tij vdesin
- 3 Ruthi vendos t'i besojë Perëndisë dhe të ndjekë Naomin VQP
- 4 Frikërat e mundshme të Ruthit VQP
- 5 Naomi dhe Ruthi mbërrijnë në Betlehem
- 6 Ruthi punon në arat e Boazit

Pika kulmore

Boazi dhe Ruthi bien në dashuri dhe martohen

Përfundimi

Ruthi – pjesë e gjenealogjisë që çon tek Jezusi
VQSh, VQP

Mësimi

Dielli ishte i nxehtë, ndërsa dy gratë po ecnin me

mundim përgjatë rrugës me gurë. Më e reja nga të dyja gratë quhej Ruth. E moshuara, vjehrra e saj, quhej Naomi. Ata kishin ecur për shumë ditë dhe ishin të lodhura dhe të pluhurosura. Ata po udhëtonin në këmbë nga një fshat malor në vendin e Moabit në qytetin e Betlehemit në vendin e Izraelit, ku Naomi kishte jetuar shumë vite më parë. Ruthi kishte lindur dhe kishte jetuar gjithmonë në Moab, deri në atë kohë. Ndoshta kishte pamje pak të ndryshme nga ajo e njerëzve në Izrael. Kishte folur një gjuhë tjetër kur ishte fëmijë. Ndoshta ngjyra e lëkurës së saj ishte pak e ndryshme nga ajo e Naomit, por sigurisht që Perëndia i do dhe i vlerëson të gjithë llojet e njerëzve.

Shfaqni kartën me të vërtetën qendrore.

VQ

Ishte një aventurë shumë e madhe për të që të linte vendin e Moabit dhe të udhëtonte për në Izrael me vjehrrën e saj. Pse po e bënin vetëm këtë udhëtim të gjatë, të rrezikshëm? Le ta shpjegojmë.

Disa vite më parë, kur Naomi ishte e re, ajo dhe burri i saj Elimelek jetonin në Betlehem. Perëndia ishte i dashur dhe i mirë me ta dhe i dha atyre dy djem. Por një vit ndodhi një problem serioz. Le të lexojmë për këtë në Bibël

Lexoni Ruth 1:1.

Lexoni vargun prej Biblës tuaj.

Po, ishte një zi buke e tmerrshme. “Zi buke” do të thotë se të korrat nuk rriten dhe nuk ka ushqim. Ndoshta atë vit nuk kishte rënë mjaft shi dhe kështu që gruri, elbi dhe të korrat e tjera nuk u rritën. Nuk kishte grurë për të bërë bukë. Nuk kishte ushqim tjetër për të ngrënë dhe kështu njerëzit në Betlehem po vdisnin urie

Figura 2-1

Nëse keni fëmijë refugjatë në mësimin tuaj mund t'i përfshini edhe ata.

Elimeleku dhe Naomi vendosën të shkonin me të dy djemtë e tyre në një vend tjetër. Ku shkuan ata? Bibla na tregon se ata shkuan në një vend të quajtur Moab. Ata bënë një udhëtim të gjatë dhe vendosën të jetonin në atë vend malor. Edhe sot njerëzit kanë lënë vendet e tyre për shkak të një zie buke ose lufte, ose sepse janë të varfër dhe nuk kanë një punë dhe shkojnë në një vend tjetër për të punuar dhe për të fituar para. Kjo nuk është një gjë e lehtë. Ndoshta disa prej jush, fëmijë, iu është dashur të lini shtëpinë tuaj dhe të vini në këtë vend dhe po përjetoni shumë vështirësi. Edhe Naomi u përball me vështirësi.

Kur gjithçka dukej se shkonte mirë, ndodhi diçka shumë e trishtueshme. Burri i Naomit, Elimeleku, vdiq.

Pas disa kohësh, secili nga dy djemtë u martua me një vajzë nga Moabi. Njëra quhej Orpah, tjetra Ruth. Por më pas, edhe të dy djemtë vdiqën.

Sa e trishtuar dhe e vetmuar duhet të jetë ndjerë Naomi, në atë vend të huaj pa burrin e saj dhe pa djemtë e saj. Dy nuset e saj, gjithashtu ishin shumë të mërzitura.

Ato kishin shumë miq në qytetin e tyre, por secila kishte humbur bashkëshortin e saj.

Një ditë, rreth dhjetë vjet pas ardhjes së saj në Moab, Naomi i tha Ruthit dhe Orpahs, “Unë po kthehem në Izrael, në vendin tim.”

Pse e vendosi këtë? Le ta gjejmë përgjigjen këtu në Fjalën e Perëndisë.

Lexo Ruthi 1:6.

Po! Zoti kishte siguruar ushqim për njerëzit në Izrael. Ruthi dhe Orpah thanë, “Do të vijmë me ty.”

Kështu ato morën me vete disa gjëra, ndoshta i lidhën ato në një deng duke i mbajtur në kurriz dhe u nisën

Figura 2-2

Pasi kishin udhëtuar ca, Naomi u tha të dyja vajzave, “Ju keni qenë shumë të mira me mua, por tani kthehuni në jetët tuaja në Moab.”

Ato biseduan shumë me njëra tjetrën një copë herë dhe më pas Orpah puthi Naomin dhe u kthye në shtëpinë e saj dhe tek miqtë e saj. Naomi i tha përsëri Ruthit

Lexoni Ruthi 1:15.

Si u përgjigj Ruthi?

Lexoni Ruthi 1:16.

Ruthi e kishte vendosur. Ajo dëshironte të ishte me Naomin dhe të shkonte në vendin e saj. Por edhe më e rëndësishme ishte se ajo besoi në Perëndinë e Naomit. Ajo nuk besonte më në perënditë e rreme të popullit të Moabit. Kjo ishte zgjedhja më e rëndësishme që do të bënte Ruthi në jetë – që të besonte në Perëndinë e vetëm, të vërtetë dhe të gjallë, të Cilin ne e njohim nëpërmjet Biblës. Ndoshta Ruthi ende nuk e kuptonte atë plotësisht, por Perëndia i do dhe i vlerëson të gjithë njerëzit.

Vendosni në tabelë fjalët e së vërtetës qendrore.

Perëndia e donte këtë grua nga Moabi dhe kështu ajo mund t'i besonte Atij.

Perëndia të do dhe të vlerëson edhe ty. Ai dëshiron që ti të bësh të njëjtën zgjedhje që bëri Ruthi – të besosh në Të. A ke menduar ndonjëherë, “Askush nuk më do vërtetë! Nuk ka asnjë njeri tek i cili mund të besoj plotësisht?” Sigurisht që ka! Ai person është Perëndia! Ai të krijoi ty. Ai kujdeset për ty. Ai thotë kështu në Fjalën e Tij (Gjoni 3:16). Edhe pse nuk e ke dashur dhe nderuar Atë, Ai të do. Ai të do, edhe pse ke thyer urdhërimet ose ligjet që Ai na i ka dhënë në Bibël. Për shembull, Ai të urdhëron të nderosh dhe t'i bindesh prindërve të tu (Eksodi 20:12). A e ke bërë këtë gjithmonë? Ai të urdhëron që të mos gënjesht (Eksodi 20:16). A i ke thënë gjithmonë të vërtetën prindërve dhe mësuesve të tu?

Ai të urdhëron që të mos vjedhësh (Eksodi 20:15). A ke marrë ndonjëherë gjëra që nuk të përkasin ty? Ndoshta ke gjetur diçka që duhet t'ia dorëzoje mësuesit ose një personi tjetër – por ti e ke mbajtur

Lexoni (ose kini një fëmijë më të rritur që të lexojë) vargun prej Biblës tuaj.

Lexoni vargjet prej Biblës tuaj.

VQ

Vëreni veten tuaj në dispozicion për këshillim personal.

atë. Kjo është vjedhje. Me siguri i ke thyer ligjet e Perëndisë shumë herë. Ky është mëkat dhe mëkati është shumë serioz në sytë e Perëndisë sepse Ai është kaq i përsosur dhe i pastër. Por në të njëjtën kohë Ai të do ty dhe dëshiron të të falë. Mund të besosh plotësisht në të pikërisht ashtu si Ruthi po mësonte të besonte.

Nëse nuk je shumë i sigurt se si mund të të falen mëkatet, qëndro pas mbarimit të klubit, unë do të jem këtu afër tabelës. Do të bisedoj me ty me kënaqësi dhe do të ta shpjegoj me më shumë detaje

Figura 2-3

Naomi dhe Ruthi ecën e ecën në rrugën që të çonte për në Izrael. Ishte verë dhe ditë duhet të kenë qenë vërtetë të gjata dhe të nxehta. Të dyja gratë duhet të kenë qenë të lodhura çdo natë kur ato shtriheshin për të fjetur. Nuk i dimë të gjitha detajet e udhëtimit. Ndoshta disa netë ato fjetën në hane ose bujtina. Ndoshta disa netë të tjera fjetën jashtë nën një pemë ose në cep të një fushe.

Por çfarë mendonte Ruthi. Ndoshta ishte e shqetësuar se së shpejti do të arrinte në një vend të huaj, ku nuk do të njihnte asnjë tjetër përveç Naomit. Njerëzit do të ishin izraelitë. Ajo ishte nga Moabi, një vend që kishte qenë në luftë me Izraelin. Gjithashtu mënyra se si fliste ishte e ndryshme. Ndoshta po mendonte se do të ndihej shumë e vetmuar; se izraelitët nuk do ta pëlqenin dhe nuk do të donin që ajo të jetonte në tokën e tyre.

Figura 2-4

A ndihesh nonjëherë ashtu si mund të jetë ndierë Ruthi? Ndoshta ti je pak ndryshe nga fëmijët e tjerë në klasën tënde ose në shkollë ose edhe sot këtu. A tallen të tjerët me ty apo të trajtojnë keq sepse ata janë rritur në këtë vend (ose qytet) dhe ti jo? Ata i përkasin një feje tjetër nga e jotja. Ata flasin një gjuhë tjetër nga ajo që ti flet në shtëpi. Shumica e fëmijëve kanë një ngjyrë lëkure të ndryshme nga e jotja. Duket se ata kanë më shumë para për të harxhuar se sa ti. Ose ndoshta fëmijët e tjerë tallen me ty sepse ti nuk luan mirë në sportet, ose se nuk ke veshje trendi. Gjëra të tilla të bëjnë të ndihesh i huaj, i padëshiruar e ndoshta i vetmuar.

Mbaj mend, unë jam miku yt dhe mund të bisedosh me mua personalisht pas mbarimit të klubit dhe të më tregosh për ndonjë problem të tillë. Do të bëj çdo gjë që mundem për të të ndihmuar. Por para së gjithash më lejo të të tregoj për Personin që mund të të ndihmojë me të vërtetë.

Është Dikush që kujdeset për ty dhe të do ty thellësisht. Ai është Perëndia. Ai di gjithçka për ty. Ai dëshiron të kujdeset për nevojën tënde më të madhe dhe dëshiron të të ndihmojë edhe në problemet e tjera. A e di se cila është nevoja jote më e madhe? Në të vërtetë nuk është pranimi nga të tjerët.

Nevoja jote më e madhe është që të të falen mëkatet e tua ndaj Perëndisë. Ai dëshiron të të falë dhe të të bëjë të pastër.

VQ

Zbatoni këtu, - sipas ndryshimeve për të cilat "të huajt" në klasën tuaj janë të vetëdijshëm, - gjërat që i bëjnë ata të ndihen të ndryshëm ose të papërshtatshëm

Kjo është një pjesë e rëndësishme e shërbesës tuaj.

Ai të deshi ty kaq shumë sa që dha Birin e Tij, Zotin Jezus, që të ndëshkohej për mëkatin tënd. Ti meriton të ndëshkohesh për thyerjen e ligjeve të Perëndisë, por në vend të kësaj, ndëshkimin tënd e mori Jezusi. Ai vdiq në kryq në mënyrë që Perëndia të të falte ty dhe të të pranonte në familjen e Tij si fëmijën e Tij. Jezusi nuk mbeti i vdekur. Ai u ngrit prej së vdekuri dhe është i gjallë sot në mënyrë që të mund të të falë dhe të kujdeset për ty.

Nevoja jote më e madhe është që të të falen mëkatet, edhe pse mund të kesh nevoja të tjera të rëndësishme si të ndierit i padëshiruar ose i huaj, ashtu si mund të jetë ndierë Ruthi kur arriti në një vend të huaj, në qytetin e huaj të Betlehemit, dhe dëgjonte njerëz që nuk i njihte, të flisnin me një theks tjetër.

Çfarë i ndodhi Ruthit dhe Naomit pasi ato u kthyen në Betlehem? Perëndia u kujdes për ta në një mënyrë shumë të mrekullueshme.

Të varfërit e asaj kohe lejoheshin të shkonin në ara kur ishte koha e korrjes (kur fshatarët korrnin grurin dhe e çonin atë në hambare). Të varfrit mund të shkonin pas njerëzve që lidhnin kallinjtë e grurit në duaj dhe të mblidhnin ndonjë kalli që kishte mbetur – në vendet e vështira në cepat e arës ose në fund të një rreshti që ishte i vërshtirë për t'u arritur

Figura 2-5

Kështu Ruthi shkoi në ara për të parë nëse mund të mblidhte elb nga ai që ishte duke u korrur.

Në këtë pikë hyn "Ruthi".

Mësuesi Përshëndetje! Kush je ti?

Ruthi Unë jam Ruthi. Mendoj se ke qenë duke i treguar fëmijëve për mua!

Mësuesi O, Ruthi nga Bibla! Shumë mirë! Mirëserdhe në klasën tonë! Do të kishim shumë dëshirë të dëgjonim më shumë nga historia jote. Tani jemi në vendin ku ti ke arritur në Betlehem. Çfarë ndodhi pas kësaj?

Ruthi Perëndia ishte i mirë me mua. Isha e varfër dhe e huaj. Mendoja se çfarë do të më ndodhte tani. Por Perëndia vërtetë më bekoi kaq mrekullueshëm.

Mësuesi Mirë, na trego se çfarë ndodhi. A gjete punë?

Ruthi Shkova në ara për të parë nëse mund të mblidhja pak nga elbi që ishte duke u korrur. Punova në arën e një burri që quhej Boaz. Perëndia punoi në zemrën e tij kështu që ai ishte i mirë me mua dhe më lejoi që të haja me shërbëtorët e tij në kohën e drekës. Ai madje i tha shërbëtorëve të tij të linin me qëllim pak grurë për mua. Kisha mundësi të mblidhja shumë e shumë elb.

Mësuesi E mahnitshme! Perëndia po kujdesej vërtetë për ty. Çfarë ndodhi më pas?

Kjo pjesë e mësimit mund të jepet në dy mënyra të ndryshme – ose si një histori e mirëfilltë, ose si një intervistë me Ruthin që do të ishte më interesante. Një mësuese tjetër ose ndihmëse e aftë ose një person tjetër mund të vijë e përgatitur për të bërë rolin e Ruthit. Visheni atë përshtatshëm, me një shami në kokë dhe le të luaj rolin në këtë intervistë. Bëni një fotokopje të intervistës për ta praktikuar më parë.

Ruthi Vazhdova të shkoja çdo ditë në arat e Boazit dhe ai vazhdonte të ishte i mirë me mua. Më vjen pak turp ta tregoj pjesën tjetër, por ishte e mrekullueshme. Më vonë Boazi ra në dashuri me mua dhe u martua me mua. Perëndia na dha një djalë.

Mësuesi E mrekullueshme! A nuk është Perëndia madhështor! Ai u kujdes për ty kur ti ishe shumë e frikësuar në një vend të huaj. Faleminderit shumë që ishe me ne sot dhe na tregove historinë tënde. Mirëupafshim! Perëndia të bekoftë!

Ruthi Mirupafshim të gjithëve. U gëzova që ju takova të gjithë juve!

“Ruthi” del.

Figura 2-6

Boazi dhe Ruthi nuk e dinin, por qindra vite më vonë, njëri nga pasardhësit e tyre do të ishte Zoti Jezus.

Sigurisht, ati i vërtetë i Zotit Jezus ishte Perëndia, por Ruthi ishte stër-stër-stër-...stërgjyshja e Marisë, nënës së Zotit Jezus. Çfarë privilegji për Ruthin, gruan që dukej kaq ndryshe nga të gjithë njerëzit e tjerë në Betlehem! Perëndia e zgjodhi atë për këtë nderim të veçantë, në vend të kujtdo tjetër që jetonte atje në atë kohë!

Nëse i ke besuar Jezusit si Shpëtimtarit tënd, ai ka një plan të mrekullueshëm për ty gjithashtu. Jo të njëjtin plan që Ai kishte për Ruthin, por diçka shumë të veçantë vetëm për ty. Nëse të tjerët duket se të refuzojnë ose tallen me ty për shkak se je ndryshe nga ata në ndonjë gjë, mbaj mend që Perëndia të do. Ai të pranon, të kupton në mënyrë të përsosur sepse të ka bërë, ai ka një plan të mrekullueshëm për ty tani e për gjithë jetën tënde. Nëse dikush të lëndon kthehu tek Perëndia dhe pëshpëriti Atij, “Faleminderit që më do dhe më kupton. Faleminderit që jam shumë i veçantë për ty.” Zoti Jezus gjithashtu mund të të ndihmojë të falësh ata që nuk sillen mirë me ty. Ai mund të të ndihmojë që të jesh i mirë me ta.

Nëse kurrë nuk i ke kërkuar Zotit të t'i lajë mëkatet, a dëshiron që Ai ta bëjë këtë tani? A dëshiron që Perëndia të të ndihmojë që të mos bësh gabime? Besoji Perëndisë sot. Kërkoji Atij të t'i lajë mëkatet dhe të të bëjë fëmijën e Tij. Ka një lutje të këndëshme në Bibël me të cilët njerëzit iu lutën Perëndisë. Ja ku është, “Më laj dhe do të jem më i bardhë se bora” (Psalmi 51:7). Nëse je lutur në këtë mënyrë me sinqeritet nga zemra jote, Perëndia mund të të bëjë të pastër. Bëje këtë tani ose kur të shkosh në shtëpi. Nëse e bën, eja dhe më trego në mënyrë që unë të të ndihmoj më shumë.

Vendosni në tabelë këta emra duke lënë një hapësirë të madhe midis tyre “Davidi dhe Jozefi dhe Maria”. Gjithësesi, shpjegoni, që Bibla na jep të gjitha emrat e njerëzve që jetuan në njëmijë vitet midis Davidit dhe lindjes së Jezusit.

VQSh

Ruthi - Boazi
Obedi
Isai
Davidi
Jozefi - Maria
Jezusi

VQP

E tregova pak shpejt historinë e Ruthit, por nëse ndonjëri nga ju që jeni më të rritur dëshiron të lexojë të gjitha detajet e kësaj historie, mund ta lexoni atë këtu në Bibël

Tregojini fëmijëve se si ta gjejnë librin e Ruthit në Biblën e tyre.

Pyetjet e përsëritjes

- 1 Pse shkuan Elimeleku dhe Naomi në Moab? (Nuk kishte ushqim (një zi buke) në Izrael, vendin e tyre.)
- 2 Na trego për tre gjërat shumë të trishtueshme që ndodhën në Moab. (Bashkëshorti i Naomit, Elimeleku vdiq, dhe dy djemtë e saj vdiqën gjithashtu.)
- 3 Pse vendosi Naomi që të kthehej? (Kishte përsëri ushqim në Izrael.)
- 4 Cili ishte vendimi më i rëndësishëm që mori Ruthi në jetë? (Ajo vendosi të besonte në Perëndinë dhe jo në perënditë e moabitëve).
- 5 Pse ishte ndryshe Ruthi nga njerëzit e tjerë në Betlehem? (Ajo ishte nga Moabi, një vend tjetër; ndoshta ajo kishte pamje dhe të folur të ndryshme nga njerëzit e tjerë në Izrael.)
- 6 Çfarë e frikësonte atë? (Ndoshta kishte frikë se nuk do të pranohej dhe se do të ishte e vetmuar.)
- 7 Trego tre bekimet e mrekullueshme që Perëndia i dha asaj. (Ajo u lejua që të punonte në arat e Boazit; elbi u la me qëllim që ta merrte ajo; ajo u martua me Boazin.)
- 8 Përfytyroni sikur po flisni me Orpahn dhe pëfundojeni fjalinë. “Orpah, ti bëre një gabim të tmerrshëm që i besove perëndive të Moabit. Duhet të kishe ...” (“Duhet të kishe shkuar në Izrael dhe të mësoje t’i besoje Perëndisë së vërtetë.”)
- 9 Cila është nevoja më e madhe që ka çdo person? (Që ti falen mëkatet e tij/saj.)
- 10 Çfarë duhet të bëjë një fëmijë i krishterë nëse ndihet i lënduar kur dikush tallet me të sepse është i ndryshëm në ndonjë gjë? (Të mbajë mend që Perëndia e do dhe e pranon atë – të falenderojë Atë për këtë.)

Aktivitet

Beso në Perëndinë

Bëni fotokopje (nëse është e mundur në letër cilësore) të modelit në faqen 42 dhe mbajini gati për fëmijët të cilët duan të marrin një, pas mbarimit të klubit. Është një aktivitet për fëmijë të krishterë por mos i pengoni fëmijët e pashpëtuar që të marrin një nëse kanë dëshirë.

Shpjegoni atë që duhet të bëjnë. Ngjyrose këtë figurë të vogël. Vendose në dhomën tënde kështu. Kur ndihesh i mërzitur ose i refuzuar, beso në Perëndinë. Ai mund të të ndihmojë kur je i sulmuar.

Mësimi 3

I pastër në një botë të ndyrë (Samueli)

Shkrimi për mësuesit

1 Samuelit 2:12-26

1 Samuelit 3:1-21

E vërteta qendrore

Perëndia mund t'i pastrojë dhe t'i mbajë të pastër ata që besojnë në Të

Zbatimi

Të pashpëtuar: Besoji Perëndisë që të të pastrojë prej mëkatit

Të shpëtuar: Besoji Perëndisë që të të mbajë të pastër

Synimi

Fëmijë që përballen me tundime (veçanërisht të një natyre seksuale) do të rezistojnë, të frymëzuar prej historisë që tregon se si Perëndia mundësoi Samuelin të qëndronte i pastër

Ku përdoret

Veçanërisht përdoret me fëmijë të ekspozuar ndaj leximit të materialeve apo skenave në TV/video etj, ku prezantohet seksi i ndaluar.

Vargu përmendësh

"...më laj dhe do të jem më i bardhë se bora" Psalmi 51:7

Ndihmat vizuale

♦ Figura: 3-1, 3-2, 3-3, 3-4, 3-5 and 3-6

Metoda mësimdhënieje

Kryesisht tregime dhe pyetje që çojnë në diskutime. Përfshihet gjithashtu një kuic përsëritës.

Fjalori

Shembujt dhe fjalori në këtë mësim janë mjaftë të hollësishme. Do t'ju duhet t'i lini jashtë disa prej fjalëve dhe shprehjeve. Por jini të kujdesshëm – nëse dëgjoni fëmijët (madje edhe të vegjëlit) është e mahnitshme të dëgjosh të folurën e tyre të hollësishme për çështje seksuale, madje edhe për seksin jonormal. Fjalori në këtë mësim është i zbutur në krahasim me disa nga bisedat e tyre! Fëmijët kanë nevojë për ndihmën tuaj për t'i dhënë atyre një perspektivë biblike.

Skica e mësimi

Hyrje

Një lule në fushën e plehrave VQ

Zhvillimi i ngjarjeve

1 Samueli dhe bijtë e Elit në tempull VQ

2 Sekret i jetës së Samuelit me Perëndinë
- Ai dëgjon Perëndinë VQSh

- Ai e njeh Perëndinë personalisht – ai është pastruar VQP

- Ai i shërben Perëndisë me besnikëri – ai mbahet i pastër VQSh

3 Jetët e humbura të bijve të Elit

Përfundimi

Ndiq shembullin e Samuelit VQSh, VQP

Mësimi

Një ditë një grua po ecte përgjatë një rruge jashtë një qyteti të madh. Rruga kalonte anash një fushe të madhe plehrash. Të grumbulluara lart, njëra mbi tjetrën ishin goma të vjetra, ushqime që kalbeshin, rroba të vjetra dhe lloj-lloj plehrash të ndyra dhe me erë të keqe. Në mes të gjithë kësaj ishte diçka e bardhë që tërhoqi vëmendjen e gruas. Kur u shkoi më afër, ajo pa se ishte një lule shumë e bukur e bardhë

Figura 3-1

“Çfarë surprize e bukur,” tha ajo me vete, “të gjesh një lule të pastër në mes të gjithë kësaj ndyrësie dhe kalbësire. Do të doja të isha si kjo lule. Dua të jem e pastër në këtë botë që është kaq e mbushur me gjëra të ndyra dhe të kalbura, me mizori dhe egoizëm dhe urrejtje.”

VQ

A ndihesh edhe ti ndonjëherë kështu? Sheh lloj-lloj gjërash të “ndyra” përreth, por ti dëshiron të jesh i pastër. Djem e vajza, burra e gra bëjnë shumë gjëra që janë të gabuara dhe të “ndyra”, gjëra që duhet të duken shumë të shëmtuara para Perëndisë, i cili është kaq i pastër dhe i shenjtë. Ai i urren të gjitha këto gjëra që janë kundër vullnetit të Tij dhe urdhërimeve të tij.

Këtu janë disa gjëra që nuk e kënaqin Perëndinë:

- ◆ Dy djem që shohin një video “të ndyrë” për seksin, në televizor në dhomën e tyre të gjumit.
- ◆ Një grup fëmijësh në oborr në shkollë që qeshin me barcaleta të “ndyra”.
- ◆ Një adoleshent i ri që sheh figura seksi në revistën që ka sjellë në shtëpi vëllai i tij i madh.
- ◆ Një burrë që lë gruan dhe fëmijët e tij për të jetuar me një grua tjetër.
- ◆ Një vajzë që mbetet shtatzënë kur nuk është e martuar. Ndoshta ka fjetur me burra të ndryshëm dhe nuk e di as se kush është babai i fëmijës.

Këto akte të mëkatshme po ndodhin rreth teje. Njerëzit qeshin me to dhe tallen me to. Ndërsa sheh disa filma në televizor, ndonjëherë të duket si argëtim të bësh këto gjëra. Ndoshta ti e di që të tjerët po i bëjnë këto gjëra të gabuara por ti dëshiron të jesh ndryshe. Si mund të jetosh një jetë që është e pastër dhe ndryshe dhe gjithashtu të kesh një jetë të lumtur? Le të shikojmë një histori në Bibël, për të gjetur përgjigjen.

Figura 3-2

Me qindra vite para se Zoti Jezus të vinte në tokë, ishte një djalë i ri i quajtur Samuel. Ai punonte në tabernakullin e Perëndisë, duke ndihmuar priftin që quhej Eli. Tabernakulli ishte një tendë e madhe e bukur në të cilën populli i veçantë i Perëndisë, judenjtë, adhuronin Perëndinë, në të cilën punonin priftërinjtë. Ndoshta Samueli ndihmonte duke pastruar

Synimi i këtij mësimi është që të ndihmojë fëmijët që përballen me tundimet, veçanërisht ato të një natyre seksuale. Por nëse keni fëmijë më të vegjël në klasën tuaj mund t'i lini disa prej këtyre shembujve, ose mund t'i zëvendësoni me mëkate të tjera si gënjeshtria, zemërimi, etj.

tabernakullin, duke i mbushur llambat me vaj duke nxjerrë jashtë hirin pasi ishin bërë sakrificat në altar, duke siguruar që veshjet e veçanta që vishnin priftërinjtë të ishin të pastra dhe në vendin e duhur. Ndoshta bënte edhe punë të tjera të rëndësishme.

Mund t'ju duhet të shpjegoni "sakrificat".

Dukej sikur ishte një vend i mrekullueshëm për të jetuar dhe punuar; apo jo? Por dy bijtë e Elit ishin të rinj shumë të këqinj. Kur njerëzit vinin për t'i ofruar një sakrificë Perëndisë, një qengj ose një kafshë tjetër, këta dy bij do i kërkonin, që në fillim, pjesët më të mira të kafshëve për t'i ngrënë për veten e tyre. Nëse personi nuk donte të bënte atë që ata i kërkonin, ata urdhëronin shërbëtorët e tyre që ta merrnin me forcë. Nuk ishin vetëm egoistë, lakmues dhe të dhunshëm, por ata flinin në shtrat me vajzat. Perëndia ishte shumë i pakënaqur me mënyrën se si ata po vepronin. Lexojmë tek 1 Samuelit 2:17, "Mëkati i dy të rinjve ishte shumë i madh përpara Zotit."

Lexoni vargun prej Biblës tuaj.

Ndoshta ti nuk bën pikërisht atë që bënin këta dy burra, por edhe ti po bën gjëra që Perëndia i urren. Ndoshta ke mendime të papastra, ose thua fjalë të këqija, ose sillesh keq. Të gjitha këto janë mëkate dhe të largojnë nga Perëndia i Cili është i pastër, pa as edhe një mëkat të vetëm. Perëndia dëshiron që ti të jesh i pastër, por ti ke një zemër mëkatore dhe ndoshta ndjek shembullin e keq të një vëllai, motre ose shoku më të madh. Gjithashtu bijtë e Elit ishin një shembull i keq për të riun Samuel.

VQ

Ndoshta Samueli ishte i tunduar të jetonte si dy burrat e tjerë. Ndoshta dukej sikur këta dy shokët më të mëdhenj po ia kalonin shkëlqyeshëm – duke jetuar në këtë mënyrë imorale. Por e rëndësishme është që Perëndia ishte i pakënaqur me sjelljen e tyre. Samueli nuk e ndoqi shembullin e tyre. Jeta e tij ishte si ajo lule e bardhë në mes të fushës së plehrave. Si qëndroi i pastër ai?

Figura 3-3

Në natë, kur ai ishte akoma shumë i ri, Samueli po flinte në tabernakull. Në mes të natës ndodhi një gjë emocionuese dhe e mrekullueshme. Le ta lexojmë.

Lexoni 1 Samuelit 3:3-4.

Po, Perëndia e thirri Samuelin. Ai nuk e kuptoi se kush po i fliste. Mendoi se ishte Eli dhe kështu vrapoi tek prifti dhe e pyeti, "Për çfarë ke nevojë?"

"Unë nuk të kam thirrur," u përgjigj Eli.

Kështu që Samueli u kthye në shtrat pak sa në mëdyshje.

Përsëri Zoti thirri, "Samuel, Samuel," dhe djali vrapoi përsëri tek shtrati i Elit, duke menduar përsëri se po e thërriste i moshuari.

"Jo, nuk të kam thirrur," tha prifti për herë të dytë.

Samueli u kthye në shtrat. Dhe për herë të tretë ai dëgjoi zërin, "Samuel, Samuel!"

Lexoni (ose kini një fëmijë më të rritur që të lexojë) vargun prej Biblës tuaj.

Lexojeni vargun nga Bibla juaj.

VQSh

Edhe një herë tjetër ai vrapoi tek Eli, që ishte i shtrirë në shtrat. Këtë herë Eli e kuptoi se duhet të ishte Vetë Perëndia që po e thërriste Samuelin. Kështu që i tregoi ndihmësit të tij të ri se si të përgjigjej kur të dëgjonte se Perëndia po e thërriste përsëri. Le të lexojmë 1 Samuelit 3:10. Fjalët e fundit janë shumë të rëndësishme, “Shërbëtori yt të dëgjon.” Dhe Samueli bëri pikërisht këtë – Ai e dëgjoji zërin e Perëndisë. Ky është sekreti se si të jesh si një lule e bardhë në një fushë plehrash – dëgjoje Fjalën e Perëndisë.

Figura 3-4

Nëse dëshiron të jetosh në një mënyrë që e kënaq Perëndinë, nëse dëshiron të jesh i pastër – edhe ti duhet të dëgjosh Fjalën e Perëndisë. Këtu në Klubin tonë Lajmi i Mirë ne e hapim Biblën çdo javë dhe ju mësojmë prej saj. A po dëgjoni me vëmendje? Ky është zëri i Perëndisë ose Fjala e Perëndisë që na flet ne. Duhet ta bëni, gjithashtu, zakon që të lexoni vetë, pak nga Fjala e Perëndisë - vetëm disa vargje çdo ditë.

Përgatituni që të siguroni shënime për të lexuar ose pak ndihmë për fëmijët që të lexojnë rregullisht Biblën e tyre.

Në faqen 43 është një model i një faqembajtësi me lexime për një muaj, nga Ungjilli i Gjonit. Bëni fotokopje në letër të trashë nëse dëshironi të përdorni këtë ide.

VQP

Kam këtë faqembajtës të vogël të cilin mund ta merrni atje tek tavolina në fund pas mbarimit të klubit. Do t’ju tregojë se si mund të lexoni disa vargje çdo ditë dhe kështu të dëgjoni Perëndinë. Në këtë mënyrë njohim Perëndinë. Në këtë mënyrë zbulojmë se çfarë dëshiron Ai që të bëjmë ne. Samueli e nisi mirë, duke dëgjuar Fjalën e Perëndisë.

Samueli kishte punuar për një kohë shumë të gjatë në tabernakull para se të dëgjonte zërin e Perëndisë që ta thërriste, por ai nuk e kishte njohur vërtetë personalisht Zotin (1 Samuelit 3:7). Nuk mjafton të dish historitë në Bibël dhe të gjitha gjërat që Perëndia bëri dhe tha. Për secilin nga ne është e rëndësishme që të njohim Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tonë personal.

A e di që Zoti Jezus vdiq në kryq për të gjitha gabimet që ti ke bërë? A të vjen keq për gjërat që ke bërë duke mos iu bindur Atij? A dëshiron që Ai të të falë dhe të të ndryshojë? Ai dëshiron të jetë Shpëtimtari dhe Ndhimuesi yt. A ia ke kërkuar ndonjëherë këtë? Mund të përdorësh fjalët e vargut që kemi mësuar sot, “Më laj dhe do të jem më i bardhë se bora” (Psalmi 51:7). Mund ta bësh sot dhe Jezusi do ta dëgjojë lutjen tënde. Ai do t’i falë mëkatet e tua dhe do të të pranojë si një fëmijë në familjen e Tij. Ai do të jetë gjithmonë me ty për të të ndihmuar që të jetosh një jetë të pastër siç bëri Samueli. Sigurisht që Samueli nuk u bë i përsosur. Ai akoma bëri disa gjëra të gabuara dhe disa gabime, por Perëndia ishte me të duke e ndihmuar atë që të ishte shumë, shumë dryshe nga ata shokët e tij të këqinj. Edhe ti nuk do të bëhesh menjëherë i përsosur. Por Perëndia do të të japë ty forcën për të ndryshuar sjelljen tënde gjithnjë e më shumë.

Samueli ishte si një lule e pastër në një fushë plehrash sepse ...

- ◆ ai e dëgjoji Fjalën e Perëndisë.
- ◆ ai e njohu dhe e besoi Zotin personalisht.

Figura 3-5

Por ky nuk ishte fundi i historisë. Ai i shërbeu Zotit me besnikëri në Izrael për shumë vite (1 Samuelit 7:15). Ai i dha mësim popullit nga Fjala e Perëndisë dhe i ndihmoi ata të merrnin vendime të drejta. Ndërsa ai i bindej Zotit, Perëndia i dha atij një jetë të mirë.

Perëndia e dëshiron këtë për ty gjithashtu – nëse tashmë i ke besuar Atij si Shpëtimtarit tënd, Ai është i aftë të të mbajë të pastër dhe të të ndihmojë t’i shërbesh Atij me besnikëri. Mund të jesh një shembull për të tjerët në familjen tënde dhe në shkollën tënde.

Figura 3-6

Fëmijët të sugjerojnë përgjigjet për pesë pyetjet e mëposhtëme, para se të sugjeroni ju një zgjidhje. Sigurohuni të theksoni si më poshtë:

- (a) nëse është e mundur, nevojën për të shmangur të qëndruarit në vende, ose me njerëz që ata e dinë se do të tundohen të shohin ose dëgjojnë gjëra të “ndyra”.
- (b) rëndësinë e të bërit të asaj që thotë Perëndia në Fjalën e Tij – psh “Largohu nga pasionet rinore” (2 Timoteut 2:22), “ruaje veten të pastër” (1 Timoteut 5:22) dhe “Forcohuni në Zotin dhe në forcën e fuqisë së tij” (Efesianëve 6:10).
- (c) nevojën për t’i kërkuar ndihmë Zotit.
- (d) rëndësinë e bërjes së disa veprimeve – largohu, fike televizorin, etj.

- 1 Nëse disa shokë janë duke parë revista të “ndyra”, çfarë do të bëje ti? (Nëse do ta dije se çfarë janë duke bërë, qëndro larg tyre. Qetësisht kërkoji Zotit që të të ndihmojë dhe largohu!)
- 2 Nëse dikush po tregon barcaletë të “ndyrë”, çfarë do të bëje? (Qëndro larg! Lutu qetësisht për forcë dhe thuaj, “Jo faleminderit, nuk dua të dëgjoj atë lloj barcalete.”)
- 3 Nëse shfaqet një program i keq në televizor, çfarë do të bëje nëse do të ishte vetëm? (Fike.)
- 4 Nëse je me të tjerët duke parë televizor, çfarë do të bëje? (Pyeti ata nëse mund ta çojnë në një kanal tjetër.)
- 5 Nëse nuk duan ta çojnë në një kanal tjetër, çfarë do të bëje? (Vetëm thuaj me mirësjellje “Mendoj se do të shkoj dhe do të bëj diçka tjetër. Ndoshta do të ishte një shans i mirë për të lexuar disa vargje nga Bibla dhe për të dëgjuar zërin e Perëndisë!)

Jeta e Samuelit ishte shumë më e mirë dhe më e vlefshme se ajo e dy bijve të Elit, që po flinin me vajzat dhe po i linin shtatzënë. Perëndia ishte i pakënaqur me ta. Jetët e tyre ishin një turpërim për ta dhe për babain e tyre. Ata gjithashtu kishin një fund të trishtuar duke vdekur në një betejë ku armiku, filistejtë e mundën Izraelin.

Perëndia dëshiron që ti të jesh si Samueli dhe të marrësh këto tre hapa të rëndësishme.

- ♦ Dëgjoje Fjalën e Perëndisë. duhet ta bësh këtë këtu në klasë dhe kur e lexon Biblën vetë.

VQSh

Metoda e mësimdhënies:
Pyetje e diskutim.

VQSh, VQP

- ◆ Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd. Lutu, “Më laj dhe do të jem më i bardhë se bora” (Psalmi 51:7). Bëje sot! Nëse tashmë e ke bërë, eja e bisedo me mua pas mbarimit të klubit që të mund të të ndihmoj më shumë.
- ◆ Besoji Atij çdo ditë se do të të mbajë të pastër dhe ji një shembull për të tjerët.

Pyetjet e përsëritjes

- 1 Kush ishte Eli? (Prifti që punonte në tabernakull [tendë]).
- 2 Ku jetonte Samueli dhe cila ishte puna e tij? (Ai jetonte në tabernakull dhe ndihmonte Elin).
- 3 Pse vrapoi Samueli tek shtrati i Elit tre herë? (Mendoj se Eli po e thërriste në emër).
- 4 Samueli mësoi tre gjëra të rëndësishme që e ndihmuan atë të jetonte një jetë të pastër. Cila ishte e para? (Dëgjo Fjalën e Perëndisë).
- 5 Cila ishte gjëja e dytë e rëndësishme që mësoi Samueli? (Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd).
- 6 Përsërite vargun e sotshëm për të mësuar përmendësh. (“Më laj dhe do të jem më i bardhë se bora” Psalmi 51:7).
- 7 Çfarë bëri Samueli pasi njohu Zotin? (Ai i shërbeu Zotit për shumë vite).
- 8 Pse është e rëndësishme që të qëndrosh larg vendeve ku e di që do të jesh i tunduar të shikosh ose të dëgjosh gjëra të “ndyra”? (Hapi i parë për të përballuar tundimin është që të qëndrosh larg vendeve ku mund të jesh i tunduar).

Aktivitet

Të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë.

Bëni fotokopje të lules në faqen 44.

Fëmijët që kanë dëshirë mund të marrin një kopje kur të largohen. Tregojini atyre që t’ia shpjegojnë historinë e lules njërit prej prindërve (ose të dy prindërve) dhe t’u tregojnë atyre se çfarë kanë mësuar këtë javë në Klubin Lajmi i Mirë.

Mësimi 4

Të mësosh të falësh të tjerët (Pjetri)

Shkrimi për mësuesit

Mateu 18:21-35

E vërteta qendrore

Perëndia i ofron falje të gjithëve

Zbatimi

Të pashpëtuar: Prano faljen e Perëndisë si hapi i parë për të falur të tjerët

Të shpëtuar: Falini ata që ju kanë lënduar

Synimi

Fëmijët e pashpëtuar do të mësojnë se Perëndia dëshiron që t'i falë ata dhe ata do të marrin faljen e Tij. Fëmijët që e dinë se Perëndia i ka falur do të kenë mundësi të falin të tjerët (të rritur ose fëmijë) që i kanë lënduar ata.

Ku përdoret

Në një shumëllojshmëri situatash, por veçanërisht aty ku fëmijët janë lënduar fizikisht ose emocionalisht nga fëmijët e tjerë ose nga të rriturit; edhe në rastet ekstreme kur fëmijët janë neglizhuar ose braktisur prej prindërve.

Vargu përmendësh

“Por jini të mirë... duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin” Efesianëve 4:32.

Fëmijët më të vegjël mund të mësojnë vetëm gjysmën e vargut.

Ndihmat vizuale

♦ Figura: 4-1, 4-2, 4-3, 4-4, 4-5 dhe 4-6

Metoda mësimdhënieje

Të përfshira në tekst janë edhe tre sete pyetjesh, krahas tregimit. Kjo temë e faljes është një temë që vërtetë u flet zemrave të fëmijëve dhe ata mund të kenë edhe pyetje të tyre. Kaloni kohë duke diskutuar me ta. (Nuk duhet t'i mësoni përmendësh pyetjet – nuk ka problem nëse i lexoni). Kjo është një metodë mësimdhënieje e rëndësishme. Nuk është shtuar një kuic përsëritës sepse vetë mësimi ka shumë pyetje.

Skica e mësimit

Hyrje

Monika

Zhvillimi i ngjarjeve

- 1 Pjetri, dishepulli, bën një pyetje lidhur me faljen
- 2 Jezusi tregon historinë e mbretit që fali njeriun që i detyrohej para VQP
- 3 Njeriu që u fal nuk fal një njeri që i detyrohej atij VQSh

Përfundimi

Fali të tjerët VQSh

Prano faljen e Perëndisë si hapin e parë drejt faljes së të tjerëve VQP

Mësimi

Figura 4-1

Monika ishte një vajzë që merrte pjesë në Klubin Lajmi i Mirë. (Kjo është një histori e vërtetë). Ajo vinte nga një shtëpi ku nuk kishte lumturi.

Ajo kishte një vëlla të madh që quhej Mikel por që nuk ishte një vëlla i vërtetë, sepse babai i tij nuk ishte babai i Monikës. Nëna e Monikës nuk i trajtonte njëllor të dy fëmijët. Ajo gjithmonë e përqafohte dhe e puthte Mikelin. Ajo kurrë nuk e përqafohte ose ta puthte Monikën. Ajo i jepte dhuratat të bukura Mikelit për ditëlindje, por kurrë nuk i dha ndonjë dhuratë Monikës.

Metoda e mësimdhënies:
Diskutim i pyetjeve.
Mësuesi komenton përgjigjet e fëmijëve.
Fëmijët mund të kenë më shumë pyetje. Kaloni kohë duke u përgjigjur.

- 1 Si mendoni, si ndihej Monika nga brenda? (Ajo ndihej shumë e mërzitur, e zemëruar dhe e refuzuar.)
- 2 Si mendoni, si veproi ajo në Klubin Lajmi i Mirë? (Asaj i pëlqente, por silllej shumë keq për shkak të zemërimit, ndjenjave të këqija që kishte brenda.)
- 3 A do të ishte e mundur që Monika të falte nënën e saj që e kishte trajtuar atë aq padrejtësisht? (Po, por nuk do të ishte aspak e lehtë. Perëndia mund ta ndihmonte atë.)
- 4 A ishte i kënaqur Perëndia me nënën e Monikës? (Aspak, edhe pse Perëndia e do atë ashtu siç i do të gjithë të tjerët.)
- 5 A do të ishte i kënaqur Perëndia me Monikën nëse ajo nuk do të mësonte të falte nënën e saj? (Jo. Ai e kupton se sa e vështirë është që të falësh, por nëse Monika do të besonte në Të që Ai ta ndihmonte, Ai do ta ndihmonte atë të mësonte të falte.)

Ndoshta ti ndihesh i mërzitur dhe i zemëruar përbrenda, sepse dikush ka qenë i pasjellshëm me ty – ndoshta fëmijë të tjerë, ose disa të rritur. A do të doje të mësojë këtë mësim të rëndësishëm se si të falësh?

Nuk është e lehtë, por ne mund të mësojmë se si ta bëjmë këtë nga Fjala e Perëndisë.

Figura 4-2

Pjetri kishte një pyetje për Jezusin rreth të falurit të njerëzve. Le të lexojmë se çfarë pyetje bëri ai.

Lexoni Mateu 18:21.

Ai dëshiron të dijë nëse duhet të jetë i përgatitur për të falur një person deri në shtatë herë. Ndoshta ishte dikush që vazhdonte të bënte gjëra të këqija kundër Pjetrit. Ishte përpjekur ta falte disa herë, por durimit të tij po i vinte fundi. Mendoj se Pjetri priste që Jezusi të thoshte, “A po, shtatë herë është mjaftueshëm.” Por Zoti Jezus u përgjigj (Mateu 18:22), “490 herë.” Me këtë donte të thoshte, shumë herë! Duhet të mësoni të falni shumë herë! Më pas Zoti i tregoi një histori Pjetrit dhe dishepujve të tjerë për t’i ndihmuar ata që të kuptonin.

Lexoni vargun prej Biblës tuaj.

Figura 4-3

Një herë një mbret po kontrollonte librin e tij ku shënonte të gjitha llogaritë e parave të tij. Ai gjeti aty se një burrë i detyrohej atij një shumë të madhe parash. Shikoni vargun 24 dhe gjeni se sa i detyrohej ky njeri. Po, 10,000 talenta. Kjo ishte një shumë absolutisht e madhe. Me paratë e sotme do të ishte miliarda lekë.

Ai e thirri atë burrë dhe i tha se kishte ardhur koha që të kthente paratë. Si reagoi ai burrë? Shikoni vargun 26. Ai bëri tre gjëra. Çfarë ishin ato? Po, ai i ra në gjunjë, i kërkoi mbretit që të ishte i durueshëm me të dhe i premtoi se do të kthente paratë. Ishte një shumë kaq e madhe, sa do të ishte plotësisht e pamundur për burrin e varfër që të fitonte të gjitha këto para dhe të paguante detyrimin. Do të ketë pasur një pamje kaq të tmerrshme dëshpërimi në fytyrën e burrit aq sa mbreti bëri një gjë shumë, shumë të mirë. Çfarë bëri ai? Le të shikojmë vargun 27. Ai “I shtyrë nga dhembshuria (i erdhi keq për të), e la të lirë atë dhe ia fali detyrimin.” Burri do të ketë qenë kaq i lumtur dhe mirënjohës ndaj mbretit që i kishte treguar atij kaq shumë mirësi. Jam i sigurt se ai doli nga ai vend duke u hedhur nga gëzimi dhe u drejtua për në shtëpi për t’i treguar gruas dhe fëmijëve të tij lajmin e mirë dhe të mrekullueshëm.

A mendo se Pjetri e kuptoi arsyen pse Jezusi po i tregonte atij dhe të tjerëve këtë histori? A e kupton ti? Jezusi po i kujtonte Pjetrit dhe të gjithëve ne, se është një Mbret i madh para të cilit kemi një detyrim shumë të madh. Ai Mbret është Perëndia.

Ai na ka urdhëruar ne në Fjalën e Tij, Biblën, që të bëjmë atë që është e mirë. Ai të urdhëron që të thuash gjithmonë të vërtetën, gjithmonë t’i bindesh prindërve të tu, të jesh i mirë me të tjerët dhe mbi të gjitha ta duash Atë me gjithë zemrën tënde. A i je bindur gjithmonë Perëndisë duke bërë këto gjëra? Jo, as unë, as edhe ndonjë tjetër. Të gjithë ne kemi bërë shumë gjëra të gabuara dhe nuk i jemi bindur Mbretit të madh. Po ashtu, edhe ti, ke një detyrim të madh ndaj Tij, sepse shumë herë nuk i je bindur Atij dhe nuk ke bërë veprimet e mira që Ai pret prej teje. Ke një detyrim shumë të madh, aq të madh sa kurrë nuk mund t’ia kthesh.

Perëndia nuk është vetëm i përsosur dhe i shenjtë, Ai është i dashur dhe i mirë. Çfarë dëshiron të bëj Ai për ty? Ai dëshiron të të falë. Ti meriton të ndëshkohesh për të gjithë mosbindjen tënde ndaj Tij. Por Zoti Jezus, Biri i vetëm i Perëndisë u ofrua për të marrë ndëshkimin që meriton ti (Romakëve 5:8). Ai erdhi nga Qielli dhe edhe pse kurrë nuk bëri as edhe një gjë të gabuar, ai shkoi në kryq dhe atje Perëndia, Ati i Tij i dashur, e lejoi që të vdiste për të gjitha mëkatet që ti dhe unë kemi bërë. Ai nuk qëndroi i vdekur; Ai u ringjall përsëri dhe u kthye në shtëpinë e Tij në Qiell.

Sot, nëse kurrë nuk e ke bërë më parë, eja tek Perëndia në lutje. Thuaji se ke gabuar. Thuaji se të vjen keq për mënyrën se si je sjellë. Falenderoje atë që mori ndëshkimin për mëkatet e tua në kryq dhe kërkoi Atij që të vijë në jetën tënde të të falë dhe të të ndryshojë.

Kini një fëmijë më të rritur që të lexojë vargun prej Biblës tuaj.

Kini një fëmijë më të rritur që të lexojë vargun prej Biblës tuaj.

Lexoni vargun prej Biblës tuaj.

VQP

Ai premton se nëse kthehesh prej mëkatit tënd dhe kthehesh tek Ai, mëkatet e tua do të “shlyhen” (Veprat 3:19). Do të jesh si burri në historinë që tregoi Jezusi, detyrimet e të cilit u fshinë. Por historia nuk mbaron aty

Figura 4-4

Burri doli nga pallati i mbretit kaq i lumtur. Rrugës për në shtëpi ai takoi një burrë tjetër. Papritur ai u kujtua, “Ky njeri më detyrohet disa para.” Nuk ishte një shumë e madhe, patjetër që nuk ishte e madhe, nëse e krahason me shumën e madhe që vetë ai i detyrohej mbretit. Tani, çfarë do të bëj ai? Le t’i vëmë të dy burrave nga një emër. Si do ta quajmë të parin? Ilir? Dhe të dytin? Fatmir? Në rregull?

Metoda e mësimdhënies:
Pyetje dhe përgjigje.

- 1 Si duhet ta trajtojë burri që u fal nga mbreti (Iliri) personin që i detyrohet atij disa para (Fatmiri)? (Ai duhet ta falë atë menjëherë)
- 2 Pse duhet ta fali Iliri, Fatmirin? (Sepse mbreti sapo i kishte falur atij detyrimin e tij.)
- 3 Kush është Mbreti i madh i cili dëshiron të na falë detyrimin tonë të madh? (Perëndia.)
- 4 A do të mund ta paguanim ndonjëherë vetë këtë detyrim? (Jo.)
- 5 Do të ishte pak e vështirë për Ilirin që të falte Fatmirin. Pse? (Sepse do të humbiste paratë që kishte shpresuar se do t’i ktheheshin.)
- 6 Mund të jetë ende pak e vështirë për ty dhe mua që të falim një person tjetër që na ka lënduar. Nëse është kështu çfarë duhet të mbajmë mend? (Që Perëndia na ka falur ne shumë, shumë më tepër.)
- 7 A mund ta thuash vargun e sotshëm përmendësh dhe të ma shpjegosh? (Vargu: “Por jini të mirë... duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin” Efesianëve 4:32.)
- 8 Çfarë mendoni çfarë bëri Iliri? A i tha ai Fatmirit se nuk duhet t’i paguante atë shumë të vogël parash që i detyrohej? (Le të kthehemi tek historia e Biblës dhe ta shohim.)

Figura 4-5

Tek Mateu 18:28 shohim se çfarë bëri burri të cilin mbreti e kishte falur – që e quajmë Ilir – kur takoi shokun e tij. Le ta lexojmë.

“Mbasi e zuri për fyti, po e mbyste duke thënë: “Më paguaj detyrimin që më ke!” (Mateu 18:28).

Çfarë mënyre e tmerrdhem reagimi! A mund ta imagjinoni? Iliri duke e kapur për fyti Fatmirin dhe duke i ulërirë “Duhet të ma paguash!”

Lexoni me zë nga Bibla
juaj.

Fatmiri ra në gjunjë dhe iu lut, “Ki durim me mua, dhe do t’i paguaj të gjitha.” Por Iliri nuk ishte i durueshëm ose i mirë. Ai e futi Fatmirin në burg sepse nuk i kishte paguar detyrimin.

Disa njerëz e kishin parë të gjithë këtë skenë dhe e kishin dëgjuar Ilirin që bërtiste dhe vepronte me mizori. Ishin shumë të zemëruar dhe shkuan dhe ia treguan mbretit atë që kishte bërë Iliri. Mbreti ishte kaq i zhgënjyer dhe i zemëruar sa që vendosi ta ndëshkonte Ilirin. Historia përfundon me Ilirin në burg dhe në gjendje të mjerë.

Çfarë fundi i trishtueshëm për këtë histori! Shumë njerëz ishin të zemëruar, të mërzitur dhe të trishtuar.

Figura 4-6

- 1 Si mendoni si është ndierë mbreti kur dëgjo për sjelljen e Ilirit? (Ai ishte i zemëruar dhe i zhgënjyer - vargu 34.)
- 2 Si ndihet Perëndia, Mbreti i madh kur ti nuk dëshiron të falësh dikë tjetër, veçanërisht nëse je fëmija i Tij dhe tashmë Ai t’i ka falur të gjitha mëkatet? (I mërzitur, i inatosur dhe i zhgënjyer.)
- 3 Si u ndienë njerëzit që panë sjelljen e Ilirit? (Ata gjithashtu ishin të zemëruar - vargu 31.)
- 4 Si mund të ndihen njerëzit e tjerë nëse shohin se nuk dëshiron të falësh? (Ata gjithashtu mund të jenë të zhgënjyer)
- 5 Po i shkreti Fatmir, si do të ndihej? (Ka mundësi i mërzitur dhe i zemëruar.)
- 6 Si mendoni, si u ndie vetë Iliri kur përfundoi në burg? (I turpëruar dhe i mërzitur.)
- 7 Si do të ndihesh ti nëse nuk mëson të falësh? (Nuk do të jesh i lumtur me gjithë ato mendime të hidhura përbrenda. Ndoshta do të sillesh, gjithashtu, keq sepse ke atë qëndrim mosfalës në zemër.)

A i ke kërkuar Zotit Jezus të të falë mëkatet dhe të të shpëtojë? Po? Atëherë, nëse Ai të ka falur kaq shumë, kërkoji Atij të të ndihmojë të falësh të tjerët kur ata bëjnë diçka që të lëndon.

Le ta themi përsëri së bashku vargun përmendësh. “Por jini të mirë... duke e falur njëri-tjetrit, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin” (Efesianëve 4:32).

Nuk është gjithmonë e lehtë që të falësh. Por Perëndia mund të të ndihmojë ty që ta bësh këtë. Kur mëson të falësh, ndodhin katër gjëra të mrekullueshme:

Tregoni lart me gisht.

- 1 Perëndia do të kënaqet.

Tregoni përpara.

- 2 Personi që do të falësh do të jetë falenderues.

Metoda e mësimdhënies:
Pyetje dhe përgjigje.

VQSh

VQSh

Tregoni përreth.

3 Njerëzit e tjerë që shohin sjelljen tënde të mirë do të bekohen.

Tregoni nga vetja.

4 Vetë ti do të jesh më i lumtur sepse ke bërë gjënë e drejtë, edhe pse ishte e vështirë.

Fëmijët le të përsërisin fjalët dhe të bëjnë veprimet.

VQP

Nëse kurrë nuk ke ardhur tek Perëndia për t'i kërkuar falje, bëje sot. Ashtu si edhe mbreti në histori e fali burrin që i detyrohej shumë para, po ashtu Mbreti i madh në Qiell dëshiron të të falë ty.

Perëndia thotë, "Pendohuni, pra, dhe kthehuni, që të shlyhen mëkatet tuaja" (Veprat 3:19). Le të ulim kokat tona në qetësi tani dhe të mbyllim sytë. Përkisht tani mund t'i kërkoj Zotit të të falë të gjithë mëkatit tënd. Nëse nuk e kupton se si t'i lutesh Perëndisë, ose dëshiron më shumë ndihmë, eja tek unë pas mbarimit të klubit dhe unë do të ulem dhe do të flas me ty për këtë çështje të rëndësishme.

Kur ti merr faljen e Tij, Ai do të të ndihmojë të mësosh se si të falësh të tjerët që mund të kenë bërë gjëra që të kanë lënduar.

Aktivitet

Falja

Bëni një fotokopje të modelit në faqen 45 për fëmijët që ata ta përfundojnë gjatë javës.

Mësimi 5

I përçmuar prej të tjerëve, i falur prej Perëndisë (Mateu)

Shkrimi për mësuesit

Lluka 5:27-32

E vërteta qendrore

Perëndia dëshiron dhe është i aftë të falë mëkatet dhe të ndryshojë jetët

Zbatimi

I Pashpëtuar: Thiri Perëndisë që të të falë

I Shpëtuar: Falendero Perëndinë që të ka falur – vazhdo t'i shërbesh Atij

Synimi

Fëmijët, mundësisht nga familje me situata jo të qëndrueshme, do të mësojnë se si të kenë faljen për gabimet e bëra. Mësimi është kryesisht ungjillizues.

Një objektiv i dytë është që të ndihmojë fëmijët që kanë ndjenja faji për gjëra për të cilat ata në të vërtetë nuk janë përgjegjës; për shembull divorci i prindërve, ose disa veprime të cilat ishin të detyruar prej të rriturve që t'i bënin

Ku përdoret

Mësimi do të ishte i përshtatshëm kryesisht për fëmijët që nuk shkojnë në kishë (në Klubet Lajmi i Mirë, kamp, Klubet Biblike të Pushimeve) por do të ishte gjithashtu i përshtatshëm për Shkollën e së Dieles.

Vargu përmendësh

Përsëritje e Efesianëve 4:32

Ndihmat vizuale

♦ Figurat: 5-1, 5-2, 5-3, 5-4, 5-5 dhe 5-6

dhe

♦ Në fund të mësimit gjithashtu do të keni nevojë për një tabelë të bardhë, fletë të madhe të bardhë.

Metoda mësimdhënieje

Janë përdorur një shumëllojshëmri metodash mësimdhënieje – çështje studimi, intervista, kërkim në Bibël si dhe tregim. Ka edhe një kuic përsëritës për të përforcuar mësimin në një mënyrë tërheqëse. Disa nga metodat e mësimdhënies do të jenë më të përshtatshme për t'u përdorur me fëmijët më të rritur (8-10 vjeç).

Si pjesë e përgatitjes tuaj, lexoni pyetjet për përsëritje dhe zbatimin në fund të mësimit. Ata do t'ju ndihmojnë të nxirrni pikat e rëndësishme të mësimdhënies në mësim.

Skica e mësimit

Hyrje

Albi falet nga babai i tij

Zhvillimi i ngjarjeve

- 1 Perëndia mund të falë mëkatet e tua VQP
- 2 Mateu tagrambledhësi tregon historinë e tij
- 3 Jeta e tij si tagrambledhës
- 4 Jezusi e thërret atë që ta ndjekë
- 5 Jeta e tij ka ndryshuar – ai bëhet një dishepull

VQP

Pika kulmore

- 6 Perëndia fal dhe i shlyen mëkatet tona kur i besojmë Atij VQ
- 7 Mos u ndiej fajtor për gjërat për të cilat nuk ke faj

Përfundimi

Eja tek Zoti Jezus sot

VQP, VQSh

Mësimi

Figura 5-1

Albi ishte nëntë vjeç. Një ditë në shkollë ndodhi një zënkë e madhe ku u përfshinë disa prej klasës së tij. Albi ishte në mes të gjithë kësaj. Pastaj u inatos kaq shumë me disa nga djemtë që e kishin fyer dhe lënduar atë. Vendosi të merrte hak. Ditën tjetër kur duhet të ishte në banjo dhe ndërsa askush nuk po e shikonte, ai hapi disa kyçe që nuk ishin të mbyllura me çelës. Pastaj mori thikën e tij dhe preu bluzat e futbollit të djemve që e kishin mërzitur.

Drejtori telefonoi babain e Albit dhe i kërkoi që të vinte në shkollë.

Figura 5-2

Albit i erdhi shumë turp ndërsa qëndronte në zyrën e drejtorit dhe ndërsa babait të tij po i tregohej e gjithë historia. Ai gjithashtu ndihej fajtor, sepse e dinte që kishte bërë diçka të tmerrshme. Babai i tij ishte shumë i mërzitur që Albi kishte hyrë në atë telash serioz. Për arsye se e donte djalin e tij, babi i Albit e kishte paralajmëruar atë shumë herë për temperamentin e tij të keq dhe për sjelljen e tij të keqe. Madje edhe e kishte ndëshkuar atë që ta ndihmonte që të mos i bënte këto gjëra të këqija.

Tani Albi tha, “Babi, më fal. Të lutem më fal. Kjo është hera e fundit që i bëj këto gjëra.”

Ai e kishte me të vërtetë. Ai e dinte se e meritonte të ndëshkohej për gjënë e keqe që kishte bërë.

Babai i tij qëndroi një moment duke menduar, pastaj tha, “Ti meriton të paguash për këto bluza sepse i preve ti. Por për shkak se të dua, do të paguaj unë për bluzat e reja të futbollit. Dhe unë të fal.” Ai e tregoi këtë duke i dhënë djalit të tij një përqaftim.

Ajo ditë e ndryshoi me të vërtetë sjelljen e Albit. Për shkak se babai i tij ishte kaq i mirë me të, që prej asaj kohe ai u soll shumë më mirë në shkollë dhe në shtëpi. Ai dëshironte që ta kënaqte babain e tij.

Le të mendojmë për këtë histori të vogël.

- 1 Çfarë kishte bërë babai i Albit duke u përpjekur që ta ndalonte atë së bëri gabime? (Babai i tij e kishte paralajmëruar atë për temperamentin e tij të keq dhe madje e kishte ndëshkuar ndonjëherë.)
- 2 Për faj të kujt kishte hyrë Albi në telash – të tijin apo të babait të tij? (Të tijin.)
- 3 Si e tregoi babai që ai e kishte falur vërtetë Albin? (Ai i dha djalit të tij një përqaftim dhe pagoi për bluzat e reja.)
- 4 Çfarë i kushtoi babait falja e Albit? (Çmimi i bluzave.)
- 5 Çfarë mendoni, pse vendosi babai i tij ta falte Albin? (Sepse ai e

donte atë.)

Në njëfarë mënyre, kjo është një pamje e mënyrës se si Perëndia fal, por falja e Perëndisë është edhe më e mrekullueshme. Perëndia është i gatshëm dhe i aftë që të falë mëkatet dhe të ndryshojë jetët.

Ti dhe unë jemi si Albi. Bibla na tregon se të gjithë kemi gabuar. Ndoshta ti nuk ke bërë atë që bëri Albi, por po, ti ke bërë gjëra të tjera që nuk e kënaqin Perëndinë dhe e mërzisin Atë.

Kur gënjen, ose e humb durimin ose nuk i bindesh prindërve, ti gabon ndaj njerëzve të tjerë, por veçanërisht je duke mëkatuar kundër Perëndisë. Në Bibël, Fjalën e Tij, Ai na urdhëron të themi të vërtetën dhe Ai thotë, “Fëmijë, binduni prindërve tuaj” (Efesianëve 6:1). Kur gënjen dhe nuk i bindesh prindërve, gjithashtu nuk je duke iu bindur as Perëndisë; Perëndisë së madh të Qiellit i cili është përsosmërisht i mirë.

Babai i Albit e fali djalin e tij sepse e donte. Ai ishte i gatshëm të paguante për dëmin që kishte bërë Albi. Disa prej jush kanë prindër të mrekullueshëm si ata të Albit të cilët ju duan dhe kujdesen për ju. Por ndoshta disa prej jush i kanë prindërit e ndarë. Njëri është larguar dhe keni ndiesinë se mamaja ose babai juaj nuk dëshiron që t’ju ketë. Kjo është vërtetë, vërtetë e trishtueshmë, por dua që të dini se është dikush që ju do shumë – më shumë se çdo prind; më shumë se çdo mësues, edhe pse unë ju dua. Ai person është Perëndia.

Biri i Tij, Zoti Jezus, vdiq në kryq për gabimet që ke bërë ti. Ne lexojmë në Bibël se Perëndia dërgoi Jezusin në botë që të lindte si një bebe, pastaj të jetonte një jetë të përsosur dhe së fundi të shkonte në kryq dhe të vdiste për të gjitha mëkatet e tua dhe të miat.

Figura 5-3

Në kryq, Perëndia vendosi mbi Jezusin të gjitha gjërat e këqija që ti dhe unë kemi bërë, gënjeshttrat, mashtrimin, mosbindjen, mendimet e këqija. Pastaj Zoti Jezus vuajti atë vdekje të tmerrshme për gabimet që ti dhe gjithë ne kemi bërë. Ne meritojmë të vdesim, por Jezusi vdiq në vendin tonë. Ai nuk mbeti i vdekur. Ai u ringjall dhe jeton përgjithmonë. Ai jeton dhe mund të të falë dhe të të ndryshojë ty. Babai i Albit e fali djalin e tij, por kishte një gjë që ai nuk mund ta bënte për Albin, diçka që Perëndia mund ta bëjë për ty. Çfarë ishte? (Ta ndryshonte atë). Po, babai i Albit e fali atë, por ai nuk mund ta ndryshonte atë përbrenda. Perëndia mund ta bëjë këtë. Nëse dëshiro që Perëndia të të ndryshojë, mund të lutesh dhe t’i kërkosh Atij që ta bëjë këtë. Nëse nuk je vërtetë i sigurt se çfarë duhet të bësh, eja dhe flit me mua pas mbarimit të klubit. Unë do të jem (*trego vendin*). Mos ki frikë. Unë dua të të ndihmoj dhe do të bisedoj me kënaqësi personalisht me ty.

Babai i Albit pagoi për bluzat e dëmtuara. Për shkak se Ai na do, Perëndia pagoi një çmim më të madh për ne që të falemi. Cili është

VQ

VQP

VQ

Lexojini fëmijëve Isaia 53:6.

VQP

Vëreni veten tuaj në dispozicion për këshillim personal.

ai? (Dha Birin e Tij që të vdiste në vendin tonë.)

Ka shumë histori në Bibël që tregojnë për njerëz që bënë gabime dhe që gjithashtu, duhet të jenë ndierë fajtorë.

Dua t'ju prezantoj me një burrë që jetoi kur Zoti Jezus ishte në tokë.

Në këtë pikë tregoni historinë e thirrjes së Mateut duke përdorur figurat 5-4 dhe 5-5. Ose mund të bëni një intervistë me Mateun. A mund ta bëjë dikush prej kishës suaj ose një ndihmës i aftë pjesën e Mateut? Që ta bëni më dramatike visheni personin me një rrobë të gjatë dhe me një mbulesë në kokë. Mund të keni pyetje të shkruara për të drejtuar intervistën. Personi që do të bëjë pjesën e Mateut duhet ta lexojë tekstin me kujdes që më parë, por nuk ka nevojë që t'i mësojë pjesët përmendësh.

Mësuesi Si e ke emrin?

Mateu Mate.

Mësuesi A je ti Mateu, që ishte njëri prej dishepujve të cilit Zoti Jezus i dha mësim dhe që e ndoqi Atë?

Mateu Po, vërtetë.

Mësuesi Duhet të ketë qenë e mrekullueshme të ishe mik i Zotit Jezus. Apo jo?

Mateu Po, sigurisht! Edhe tani e kam të vështirë ta besoj që Perëndia e lejoi një person si unë, të mësonte nga Jezusi dhe të ishte me Të për tre vjet. Kisha bërë gjëra kaq të tmerrshme më parë.

Mësuesi A do të na tregosh pak nga historia jote? Kam qenë duke pritur për të të takuar. Madje kam edhe disa pyetje të shkruara të cilat dua të t'i bëj ty. Mirë?

Mateu Po. E dini, kam bërë gjëra që tani më bëjnë të ndihem i turpëruar. Romakët kishin pushtuar tokën tonë Izraelin dhe sundonin mbi ne për shumë vite. Ata na kërkonin ne judejve që t'i paguanim atyre shumë para ose taksa. Populli jude ndiheshin shumë të mërzitur dhe të zemëruar që nuk mund të sundonin vetë por duhet t'i bindeshin romakëve; por unë punoja për romakët. Tani kjo më bën të dihem shumë i turpëruar.

Mësuesi Pse të vjen turp?

Figura 5-4

Mateu unë punoja për armiq të popullit tim. Isha si një tradhëtar për ta. Ndihesha keq dhe fajtor përbrenda meje në atë kohë por sigurisht që nuk e tregoja nga jashtë. Nuk i mblidhja taksat në një mënyrë që nuk tërhiqte vëmendjen.

Përkundrazi ngrita një zyrë të vogël pikërisht në rrugë në vendin ku kalonin të gjithë dhe aty i mblidhja paratë. Ne tagrambledhësit shpesh

merrnim më shumë para sesa duhet të merrnim dhe i mbanim për vete në vend që t'ia dorëzonim romakëve.

Mësuesi Por e gjitha kjo ndryshoi, apo jo?

Figura 5-5

Mateu Po, sigurisht që ndryshoi! Një ditë Zoti Jezus po kalonte në rrugë dhe më thirri që ta ndiqja.

Mësuesi A e dije se kush ishte personi që po të thërriste që ta ndiqje?

Mateu Kisha dëgjuar për gjërat e mrekullueshme që bëri dhe tha Ai. Në atë kohë në të vërtetë nuk i dija të gjitha gjërat që di tani – që Ai është Perëndia Bir, i Cili zbriti prej Qielli për të vdekur në kryq që mëkatet tona të mund falen dhe që jetët tona të mund të ndryshojnë. Vetëm më vonë e kuptova që Ai vdiq për të gjitha gabimet që unë dhe që secili prej nesh ka bërë.

Mësuesi Pra çfarë bëre ti kur Ai të thirri që ta ndiqje Atë?

Mateu Atë ditë u ngrita nga tavolina ime dhe e ndoqa. Isha kaq i kënaqur sa që bëra një festë të madhe në shtëpinë time. Jezusi, miqtë e Tij dhe disa nga miqtë e mi tagrambledhës erdhën të gjithë dhe ia kaluam shumë mirë së bashku. Disa njerëz e kritikuan Jezusin sepse po hante me ne tagrabledhësit.

Mësuesi Si u ndieve kur Jezusi erdhi në shtëpinë tënde?

Mateu Ishim shumë të gëzuar që Ai ishte gati të rrinte me ne. U ndjeva kaq keq dhe kaq fajtor përbrenda. Mësova t'ia besoj Jezusit. Unë e di se Ai më ka falur për gabimet që kam bërë. E di që Ai u ndëshkua në kryq në mënyrë që unë të mos ndëshkohesha. Ai më ka ndryshuar dhe ato ndienjat e fajit janë larguar!

Ndoshta ashtu si Albi, ose Mateu në kohën e Jezusit, edhe ti e di që ke gabuar. Nuk i je bindur Perëndisë dhe tani ndihesh keq dhe fajtor përbrenda. Perëndia të do dhe dëshiron të të falë dhe të të ndryshojë.

Sot eja tek Ai. Nuk mund të shkosh duke ecur drejt Tij ashtu si bëri Mateu kohë më parë, por mund të vish tek Ai duke u lutur. Ai premton, “Atë që vjen tek unë, unë nuk do ta nxjerr jashtë kurrë” (Gjoni 6:37b). Thuaji Atij se e di që ke bërë gabime. Thuaji Atij se dëshiron që Ai të të ndryshojë. Falenderoje Atë, Birin e Perëndisë që të deshi kaq shumë dhe që vdiq për të marrë ndëshkimin që meriton ti. Kërkoji Atij që të falë dhe të të ndryshojë. Eja tek Ai sot!

Çfarë bën Perëndia me të gjitha gabimet, pasi i kemi kërkuar Atij të na falë? Le ta shohim.

Figura 5-6

Vargu biblik Çfarë bën Perëndia

VQP

VQ

PowerPoint 5-6a,b,c,d,e

Në shirita të ndara letre printoni pesë vargjet e dhëna. Vendosini ato në Biblën tuaj në mënyrë që pjesa e fundit të dalë jashtë. Ftoni një fëmijë të vijë dhe të tërheqë një varg nga Bibla juaj dhe

VQP

ta lexojë atë. Pastaj mësuesi ta shkruajë në tabelë (ose t'i shfaqë në një kartë) fjalët që tregojnë atë që bën Perëndia me mëkatet tona. Bëjeni këtë me secilin nga pesë vargjet.

Veprat 3:19 Ai i shlyen mëkatet tona.
Mikea 7:19 Ai i hedh ato në fund të detit.
Psalmi 51:2 Ai i pastron ato.
Isaia 44:22 Ai i fshin ato.
Hebrenjve 8:12 Ai nuk i kujton më ato.

Eja sot tek Zoti! Ai dëshiron të të pranojë – të të falë dhe të të ndryshojë!

Në këtë pikë, ose në një moment tjetër gjatë programit, sipas dëshirës mund të shtoni si më poshtë.

Disa djem dhe vajza ndihen fajtorë për diçka për të cilën, në të vërtetë, nuk është faji i tyre. Për shembull, kur mami dhe babi ndahen dhe njëri prej tyre largohet, fëmijët mund të mendojnë, “Është i gjithi faji im. Unë e kam fajin që mami ose babi u largua” – por nuk është faji yt. Ai është një vendim që e kanë marrë të riturit. Mbase ty të ka mërzitur, por nuk është faji yt.

Ndonjëherë një i rritur të kërkon që të bësh diçka të gabuar. Ti nuk dëshiron që ta bësh por ata të të thonë që të mos mëzitesh dhe të thonë që ta bësh. Ndoshta edhe të thonë që të mos i tregosh askujt. Ndërsa ti ndihesh fajtor dhe keq. Përsëri, mos e fajëso veten. Nuk është faji yt.

Nëse ke një problem të tillë dhe dëshiron të flasësh me mua, patjetër që mund të flasësh. Unë jam miku yt dhe do të të dëgjoj me kënaqësi dhe do të të ndihmoj nëse mundem.

Nëse tashmë ke besuar në Jezusin si Shpëtimtarin tënd, falenderoje atë çdo ditë që Ai të ka pranuar si fëmijën e Tij dhe të ka falur të gjitha mëkatet. Nuk duhet të ndihesh fajtor për gjërat e së kaluarës. Jezusi e mori ndëshkimin në kryq për to. Para Tij ti je i pastër. kërkoji gjithashtu Zotit Jezus çdo ditë të të ndihmojë që të jetosh në mënyrën që Ai dëshiron të jetosh. Ai mund të të ndihmojë që të jesh si Mateu tagrambledhësi që u bë dishepulli i Tij dhe u bë dikush që ndihmoi shumë njerëz të tjerë të ndjekin Jezusin.

Pyetje për përsëritje

- 1 Cila ishte puna e Mateut? (Tagrambledhës.)
- 2 Cilat ishin gjërat e gabuara që kishte bërë ai që nuk e kënaqnin Perëndinë? (Ndërsa punonte me romakët [armiqtë] me sa duket ai merrte më shumë para sesa duhej të merrte.)
- 3 Si u bë ai një prej dishepujve të Zotit Jezus? (Jezusi e thirri atë që ta ndiqte.)
- 4 Çfarë bëri ai për të treguar se sa mirënjohës dhe i lumtur ishte pasi e thirri Zoti Jezus? (Ai e ftoi Jezusin në një festë të madhe që kishte përgatitur.)
- 5 Pse rrinte Jezusi me njerëz si Mateu dhe tagrambledhësit e tjerë? (Ai erdhi në tokë për të shpëtuar të gjithë mëkatarët.)

- 6 Çfarë çmimi të madh pagoi Perëndia në mënyrë që mëkatet e Mateut (dhe tonat) të mund të faleshin? (Ai e dha Birin e Tij që të vdiste në kryq)
- 7 Si mund të të falen mëkatet? (Eja tek Jezusi dhe kërkoji që të të falë.)
- 8 Çfarë bën Perëndia me mëkatet tona kur ne ia rrëfejme ato Atij dhe besojmë në të? Më thoni dy gjëra që Ai i bën. (Ai fal; Ai i fshin ata.)
- 9 Cilat janë dy gjëra të tjera që Ai bën? (Ai nuk i kujton; Ai i shlyen ata.)
- 10 A mund ta thoni vargun përmendësh? (“Por jini të mirë... duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin” Efesianëve 4:32.)

Aktivitet

Çfarë bën Perëndia me mëkatet tona?

Bëni fotokopje në letër të trashë të modeleve në faqen 46. Ka dy rrathë. Njëri ka pyetjen “Çfarë bën Perëndia me mëkatet tona?” dhe një pjesë të prerë. Rrethi tjetër bashkohet mbrapa të parit me një mbajtëse letrash (të cilën duhet ta gjeni më parë). Rrethi i dytë ka pesë përgjigjet të printuara në mënyrë të tillë që të dalin në “dritaren” e rrethit të parë. Tregojini fëmijëve se si ta përdorin këtë ndihmë vizuale për të mësuar pesë përgjigjet.

Perëndia i pranon dhe i përdor ata që besojnë në Të


E vërteta qendrore – mësimi 1



Perëndia të do


Aktivitet - mësimi 1

Mos u mërziti!



Mbaj mend Perëndia të do

Mos u mërziti!



Mbaj mend Perëndia të do

Beso në Perëndinë

Aktivitet - mësimi 2

Nëse i përket Perëndisë, mbaj mend...

Ai mund të të ndihmojë kur sulmohesh.

Perëndia është streha jonë

“Je i huaj.”

“Nuk ke vend këtu.”

Nuk të duam.”

Beso në Të!

Nëse i përket Perëndisë, mbaj mend...

Ai mund të të ndihmojë kur sulmohesh.

Perëndia është streha jonë

“Je i huaj.”

“Nuk ke vend këtu.”

Nuk të duam.”

Beso në Të!

Nëse i përket Perëndisë, mbaj mend...

Ai mund të të ndihmojë kur sulmohesh.

Perëndia është streha jonë

“Je i huaj.”

“Nuk ke vend këtu.”

Nuk të duam.”

Beso në Të!

Nëse i përket Perëndisë, mbaj mend...

Ai mund të të ndihmojë kur sulmohesh.

Perëndia është streha jonë

“Je i huaj.”

“Nuk ke vend këtu.”

Nuk të duam.”

Beso në Të!

Faqembajtësi

Mësimi 3



Dita 1 Gjoni 1:1-12
 Dita 2 Gjoni 1:19-29
 Dita 3 Gjoni 1:30-34
 Dita 4 Gjoni 1:35-42
 Dita 5 Gjoni 1:43-51
 Dita 6 Gjoni 2:1-12
 Dita 7 Gjoni 2:13-22
 Dita 8 Gjoni 3:1-7
 Dita 9 Gjoni 3:14-21
 Dita 10 Gjoni 4:1-10
 Dita 11 Gjoni 4:11-26
 Dita 12 Gjoni 4:43-54
 Dita 13 Gjoni 5:1-9
 Dita 14 Gjoni 6:1-13
 Dita 15 Gjoni 6:16-24
 Dita 16 Gjoni 9:1-12
 Dita 17 Gjoni 10:1-13
 Dita 18 Gjoni 10:14-18;27-30
 Dita 19 Gjoni 11:1-6;14-19
 Dita 20 Gjoni 11:20-31
 Dita 21 Gjoni 11:32-44
 Dita 22 Gjoni 12:1-8
 Dita 23 Gjoni 12:12-19
 Dita 24 Gjoni 13:1-17
 Dita 25 Gjoni 13:21-30
 Dita 26 Gjoni 13:31-38
 Dita 27 Gjoni 14:1-9
 Dita 28 Gjoni 14:21-27
 Dita 29 Gjoni 15:1-12
 Dita 30 Gjoni 15:13-17
 Dita 31 Gjoni 16:5-15



Dita 1 Gjoni 1:1-12
 Dita 2 Gjoni 1:19-29
 Dita 3 Gjoni 1:30-34
 Dita 4 Gjoni 1:35-42
 Dita 5 Gjoni 1:43-51
 Dita 6 Gjoni 2:1-12
 Dita 7 Gjoni 2:13-22
 Dita 8 Gjoni 3:1-7
 Dita 9 Gjoni 3:14-21
 Dita 10 Gjoni 4:1-10
 Dita 11 Gjoni 4:11-26
 Dita 12 Gjoni 4:43-54
 Dita 13 Gjoni 5:1-9
 Dita 14 Gjoni 6:1-13
 Dita 15 Gjoni 6:16-24
 Dita 16 Gjoni 9:1-12
 Dita 17 Gjoni 10:1-13
 Dita 18 Gjoni 10:14-18;27-30
 Dita 19 Gjoni 11:1-6;14-19
 Dita 20 Gjoni 11:20-31
 Dita 21 Gjoni 11:32-44
 Dita 22 Gjoni 12:1-8
 Dita 23 Gjoni 12:12-19
 Dita 24 Gjoni 13:1-17
 Dita 25 Gjoni 13:21-30
 Dita 26 Gjoni 13:31-38
 Dita 27 Gjoni 14:1-9
 Dita 28 Gjoni 14:21-27
 Dita 29 Gjoni 15:1-12
 Dita 30 Gjoni 15:13-17
 Dita 31 Gjoni 16:5-15



Dita 1 Gjoni 1:1-12
 Dita 2 Gjoni 1:19-29
 Dita 3 Gjoni 1:30-34
 Dita 4 Gjoni 1:35-42
 Dita 5 Gjoni 1:43-51
 Dita 6 Gjoni 2:1-12
 Dita 7 Gjoni 2:13-22
 Dita 8 Gjoni 3:1-7
 Dita 9 Gjoni 3:14-21
 Dita 10 Gjoni 4:1-10
 Dita 11 Gjoni 4:11-26
 Dita 12 Gjoni 4:43-54
 Dita 13 Gjoni 5:1-9
 Dita 14 Gjoni 6:1-13
 Dita 15 Gjoni 6:16-24
 Dita 16 Gjoni 9:1-12
 Dita 17 Gjoni 10:1-13
 Dita 18 Gjoni 10:14-18;27-30
 Dita 19 Gjoni 11:1-6;14-19
 Dita 20 Gjoni 11:20-31
 Dita 21 Gjoni 11:32-44
 Dita 22 Gjoni 12:1-8
 Dita 23 Gjoni 12:12-19
 Dita 24 Gjoni 13:1-17
 Dita 25 Gjoni 13:21-30
 Dita 26 Gjoni 13:31-38
 Dita 27 Gjoni 14:1-9
 Dita 28 Gjoni 14:21-27
 Dita 29 Gjoni 15:1-12
 Dita 30 Gjoni 15:13-17
 Dita 31 Gjoni 16:5-15



Dita 1 Gjoni 1:1-12
 Dita 2 Gjoni 1:19-29
 Dita 3 Gjoni 1:30-34
 Dita 4 Gjoni 1:35-42
 Dita 5 Gjoni 1:43-51
 Dita 6 Gjoni 2:1-12
 Dita 7 Gjoni 2:13-22
 Dita 8 Gjoni 3:1-7
 Dita 9 Gjoni 3:14-21
 Dita 10 Gjoni 4:1-10
 Dita 11 Gjoni 4:11-26
 Dita 12 Gjoni 4:43-54
 Dita 13 Gjoni 5:1-9
 Dita 14 Gjoni 6:1-13
 Dita 15 Gjoni 6:16-24
 Dita 16 Gjoni 9:1-12
 Dita 17 Gjoni 10:1-13
 Dita 18 Gjoni 10:14-18;27-30
 Dita 19 Gjoni 11:1-6;14-19
 Dita 20 Gjoni 11:20-31
 Dita 21 Gjoni 11:32-44
 Dita 22 Gjoni 12:1-8
 Dita 23 Gjoni 12:12-19
 Dita 24 Gjoni 13:1-17
 Dita 25 Gjoni 13:21-30
 Dita 26 Gjoni 13:31-38
 Dita 27 Gjoni 14:1-9
 Dita 28 Gjoni 14:21-27
 Dita 29 Gjoni 15:1-12
 Dita 30 Gjoni 15:13-17
 Dita 31 Gjoni 16:5-15

Të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë

Aktivitet - mësimi 3

Nëse dëshiron të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë, si Samueli...

... Dëgjoje Fjalën e Perëndisë.



... Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd.

... Besoji Perëndisë që të të japë forcë forcë kur tundoresh.

Nëse dëshiron të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë, si Samueli...

... Dëgjoje Fjalën e Perëndisë.



... Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd.

... Besoji Perëndisë që të të japë forcë forcë kur tundoresh.

Nëse dëshiron të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë, si Samueli...

... Dëgjoje Fjalën e Perëndisë.



... Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd.

... Besoji Perëndisë që të të japë forcë forcë kur tundoresh.

Nëse dëshiron të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë, si Samueli...

... Dëgjoje Fjalën e Perëndisë.



... Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd.

... Besoji Perëndisë që të të japë forcë forcë kur tundoresh.

Nëse dëshiron të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë, si Samueli...

... Dëgjoje Fjalën e Perëndisë.



... Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd.

... Besoji Perëndisë që të të japë forcë forcë kur tundoresh.

Nëse dëshiron të qëndrosh i pastër në një botë të ndyrë, si Samueli...

... Dëgjoje Fjalën e Perëndisë.




... Njihe Zotin si Shpëtimtarin dhe Mikun tënd.

... Besoji Perëndisë që të të japë forcë forcë kur tundoresh.

Perëndia të do

Aktivitet - mësimi 4.

Nëse ke besuar në Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd,




Perëndia të
ka dhënë një
kovë të
madhe plot
me

fajle.
Kërkoji atij të të
ndihmojë t'u
japësh pak
fajle të tjerëve

Vizato një filxhan të vogël sa herë që Perëndia do të të ndihmojë që të falësh dikë këtë javë.

Tregoja faqen me filxhanë mësuësit të Klubit javën që vjen.

Nëse ke besuar në Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd,



Perëndia të
ka dhënë një
kovë të
madhe plot
me



fajle.
Kërkoji atij të të
ndihmojë t'u
japësh pak
fajle të tjerëve

Vizato një filxhan të vogël sa herë që Perëndia do të të ndihmojë që të falësh dikë këtë javë.

Tregoja faqen me filxhanë mësuësit të Klubit javën që vjen.

Çfarë bën Perëndia me mëkatet tona?

Aktivitet - mësimi 5





Përmbledhje e hapave për këshillimin e fëmijës që dëshiron të bëhet i krishterë

Sigurohu që fëmija ka kuptuar

Perëndinë

Kush është Perëndia?

Perëndia na bëri. Ai na flet nëpërmjet Biblës. Perëndia është i shenjtë dhe i pastër. Ai na do ne.

Mëkatin

Çfarë është mëkati?

Mëkati është mosbindje ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Është kundër Perëndisë.

Flisni rreth mëkateve specifike.

Fëmija është mëkatar në natyrë dhe në veprim (ne mëkatojmë sepse jemi mëkatarë).

Mëkati meriton vdekjen.

Shpëtimtarin

Kush është i vetmi që mund të të heqë mëkatin?

Perëndia Bir vdiq në kryq për mëkatarët. Zoti Jezus u ringjall prej së vdekuri. Ai është Zot mbi të gjithë.

Shpjegoni se si mund të shpëtojë

Shpjegoni se çfarë dëshiron Zoti që të bëjmë ne dhe çfarë do të bëjë Ai.

Përdorni një varg biblik (Gjoni 1:12; 3:16; 6:37; Veprat 16:31; Romakëve 6:23 or 10:13).

Çfarë dëshiron Zoti që të bësh? Çfarë do të bëj Zoti?

Paralajmëroni për vështirësitë.

Pyesni: "A dëshiron t'i besosh Krishtit, apo do të doje të prisje?"

Inkurajojeni fëmijën që të lutet me zë (nëse është gati).

Flisni për sigurinë e shpëtimit

Kthehuni tek vargu që përdoret. Flisni për një jetë të ndryshuar.

Tregojini se çfarë mund të dijë një person që i beson vërtetë Krishtit.

Jepini (më vonë) disa udhëzime për jetën e krishterë

Lexoje dhe bindju Biblës tënde.

Flit me Perëndinë Atin tonë Qiellor.

Tregoju të tjerëve se çfarë ka bërë Zoti për ty. Kërkoji Perëndisë që të të falë kur mëkaton. Takohu me të krishterë të tjerë.

Mbaj mend premtimet e Perëndisë : "Nuk do të të lë, nuk do të të braktis" (Heb 13:5).